

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7745 E premte 21 Dhjetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

**P**ranvera e këtyre ditëve të fundit të dhjetorit i ka dhënë një tjetër nur metropolit të zbuluar shumëngjyrësh. Ditët fillojë zhurmshëm dhe ...

Vijon në faqen 20

Nga REZANA KONOMI

**Për kë bien këto kambana...?!**



Opinion i Ditës

Një shoku im, Budion Pojani, tani inxhinier në Amerikë, në fillim të viteve shtatëdhjetë të shekullit që kaloi na tha se: "Enver Hoxha ka hyrë në rrugën ..."

Vijon në faqen 21

Të gjithë halldupët e politikës shqiptare rrezohen po njëllonj



Muxhahedinët në Tiranë: Akt i guximshëm

## Dëbimi i ambasadorit të Iranit, Trump i çon letër Ramës: Bashkë kundër terrorizmit

Dyshimi i përgatitjes së akteve kërcënuese, ja pse u shpallën "non-grata" dy diplomatët

Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump, i ka dërguar një letër kryeministrit Edi Rama pas dëbimit të ambasadorit iranian në Tiranë dhe një diplomati tjetër, të cilët akuzohen për komplete terroriste brenda vendit tonë. Letra është bërë publike nga ambasada amerikane në Tiranë, e cila përgëzon qeverinë ...

Në faqen 7

## PERJASHTOHET 10 DITE DEUPTETI I PD, ENDRI HASA. BERISHA: ISHIN VEZE SURRELI

# RAMA GJUHET ME VEZE NE KUVEND, PS: E NXITI BASHA

Kryeministri pas incidentit: Një trim koteci solli konfliktin e rrugës në Kuvend. Opozita në sallë për të mos djegur mandatet. Rrezohet dekreti i Metës për buxhetin



(Në foto) Punonjësit të Gardës duke u përpjekur të mbrojnë kryeministrin Rama, i cili është goditur me veze nga deputeti i PD, Endri Hasa

### PROTESTA

**Studentët përplasen fort me Ramën: Nuk tërhiqemi nga pikat, plotëso kërkesat**

Në faqen 5

### UNIVERSITETET

**Platforma e PD për arsimin, Basha: Tarifat do t'i përgjysmojmë**

Në faqen 2

### KRYETARJA E LSI

**Kryemadhi: Lindita Nikolla u dend me ilaçe, nuk e lënë që të dorëhiqet**

Në faqen 2

### REAGIMI

**Banorët e Unazës së Re në protestë: Rama të tërheqë projektin e rrugës**

Në faqen 4

### AKUZA PER PERNDJEKJE



**"Xhisiela", gjykata liron nga burgu djalin e deputetit të PS, Rrahman Rraja**

Në faqen 8

Projektvendimi/ 77 aplikime skualifikohen për parregulsi në dokumentacion

## Kreditë e buta, emrat e fituesve në listë pritjeje

Kriteret si do bëhet përzgjedhja, 4 muaj afat për lidhjen e kontratës

Nga VOLTIZA DURO

**S**ot do të mbahet mbledhja e radhës së Këshillit Bashkiak të Tiranës ku pritet miratimi i listës fituese të 456 familjeve që do të përfitojnë shtëpi me kredi të butë. Ndërkohë, pritet të miratohet edhe lista e pritjes



me 549 familjet që mund të përfitojnë nga ky program. "Komisioni vendosi se pjesa prej 549 familjesh të vendosen në listën e pritjes, e cila do të jetë e zbatueshme për rastet kur familjet e shpallura fituese nuk paraqiten, heqin dorë, nuk pranojnë dhe/ose ..."

Në faqen 9-12

# KUVENDI DEBATET

Kreu i PD-së, akuza mazhorancës: Jeni të poshtër si dreqi, por bëni budallain si gomari

Valentina Madani

## Platforma e PD për arsimin, Basha: Përgjysmim të tarifave

### "Dyfishim të buxhetit, të rrëzohet ligji"

Rikthimi i opozitës dje në Kuvend u shoqërua nga përplasje të forta mes saj dhe deputetëve të mazhorancës. Kreu i opozitës, Lulzim Basha, në fjalën e tij të parë nga foltorja e Kuvendit pas disa muajsh bojkot, kërkoi të mos futej në rend dite drafti i njëanshëm i shumicës për Reformën Zgjedhore. Basha i konsideroi deputetët e mazhorancës 'një tufë horrash dhe banditësh': "Jeni të poshtër si dreqi, por bëni budallain si gomari. Çfarë? E dini fare mirë, ka një komision. Si mund ta sjellësh pa kaluar nga komisioni këtu? Çfarë po bëni ju? Show po bëni? E keni marrë mesazhin dje nga faktori ndërko-mbëtar. Jeni hileqarë, të poshtër! Do bëni ju reformë zgjedhore, ju nuk doni vetingun politik. Del këtu shoku i trafikantit që do bëjë pallate të Unaza e re, na flet për reformë zgjedhore! Tufë hajdutësh, banditësh, gjysma juaj duhet të jetë në burg. Duke filluar me ty që zgërdhesh aty (i drejtohet Ramës). Prandaj lëri këto gomarlliqe, fillo me pikën e parë të rendit të ditës, siç ke rënë dakord", tha Basha. Kreu i demokratëve tha se në Kuvend ishte rikthyer vetëm për buxhetin e studentëve. "Të dëgjojnë se si po të ndalojë vjedhjen ky hajduti psiçik këtu mbrapa, mund të ketë para për tarifën e studentëve. Lëri gomarllëqet e tjera se s'kemi ardhur të tallemi me ju. Tufë horrash dhe banditësh. Keni shkel tre herë kushtetutën, ke shkel procedurën. Pasi keni kapur gjithçka. Po kap edhe Bankën e Shqipërisë, po kapni bordin e bankës së Shqipërisë me 28 firma të këtyre deleve të bandave të hajdutëve. Ti pusho! (i drejtohet Taulant Ballës) Ti pusho ti, se merrem me ty pastaj! More vesh, qepe gojën, bandit. Pse e ke bërë atë? Vetëm banka ka ngel pa kap, kape dhe bankën, kape. Gjitha të tjerat i ke kapur, kape dhe bankën, por do e shihni se ku do përfundoni!", deklaroi z.Basha.



Kreu i opozitës, Lulzim Basha

#### AKUZA

"Gjysma prej jush duhet të jenë në burg. Ke shkel Kushtetutën, ke shkel procedurën po kap edhe Bankën e Shqipërisë me 28 firma. Ky hajduti psiçik të ndalojë vjedhjet, lëri gomarllëqet, tufë horrash dhe banditësh. Vetëm banka të ka ngel pa kapur, po do e shihni se ku do përfundoni. Kape edhe bankën kape", - u shpreh Basha.

Tensioni gjatë seancës së djeshme parlamentare



#### KODI, SORECA: FINALIZONI AMENDAMENTET

Ambasadori i Bashkimit Europian, Luigi Soreca u bëri thirrje të dyja palëve të politikës shqiptare që të ulen dhe të miratojnë Reformën Zgjedhore. Ai e quajti këtë reformë si një nga hapat më të rëndësishëm që do ta çojë Shqipërinë drejt hapjes së negociatave të anëtarësimit në BE. "U bëjmë thirrje partive politike të tregojnë përgjegjshmëri dhe të përfundojnë TANI në parlament punën shumë të mirë të bërë nga Komiteti ad-hoc, duke miratuar amendamentet e nevojshme për Kodin Zgjedhor", - shkruan ambasadori Soreca.

## Berisha, sfidë qeverisë: Të heqim tarifën për studentët, universitetet falas

Ish-kryeministri Sali Berisha gjatë fjalës së tij në Kuvend deklaroi se protesta e studentëve është rezultat i ligjit për arsimin e lartë. Berisha tha se studentët janë "uragani" që do i japë fund qeverisjes së socialisteve. Ish-kryeministri Sali Berisha ka sfiduar mazhorancën në Kuvend të bëjnë universitetet publike falas, pa asnjë tarifë. "Para tre ditësh ishte këtu një gjerman i madh nga Bundestagu, një njeri i shquar në ekonomi. Ne në Gjermani i vendosëm njëherë këto tarifë se e kishim falas. Pas 5-6 vitesh e pamë që bëmë gabim dhe i hoqëm tarifën. A keni ju shpirt të votoni sot heqjen përfundimtare të tarifave mbi stu-



dentët shqiptarë, ky do të ishte mesazhi më i shkëlqyer, një rast që e krijoi presidenti i Republikës, të mos hyjmë në asgjë tjetër, universitetet pa tarifa për të gjithë shqiptarët kudo ku janë, e ka Greqia, e ka Gjermania. Me 90 euro e ka Maqedonia. Pse mos t'ua bëjmë ne këtë këtyre. Ata po luftojnë të jenë në Shqipëri, të bëjnë Shqipërinë. Ne në një

akt fisnik, mirënjohje, të miratojmë Universitetet publike falas. Por nuk ka lënë hajdutët dhe hajdutëria. Kjo është fatkeqësi e madhe. Jam i bindur se ata studentë do të fitojnë. Ëndërrra nuk ka forcë ta ndalojë pa shndërrimin e saj në realitet. Mjerë ju ku do të shkoni", - tha z.Berisha.

#### PLATFORMA

Kreu i opozitës Lulzim Basha prezantoi dje në Kuvend planin e PD-së për arsimin që do ta diskutojë me pedagogë dhe studentë. Nga foltorja e Kuvendit, Basha u shpreh se duhet të dyfishohet buxheti për Arsimin dhe të rrëzohet ligji aktual i arsimit. "Të dashur qytetarë gjithsecili prej jush e di çka do të thotë të cosh një fëmijë student. Kostoja mesatare është 25 mijë. Për konvikte e ushqim 220 mijë, për transport dhe urban, 25 mijë. Për

tre vite bachelor dhe dy vite master një familje shqiptare duhet të shpenzojë 15 mln lekë të vjetra. Që të mundësojë shpenzimet për një fëmijë të vetëm në universitet familja duhet të kursejë 72 mijë lekë të vjetra në muaj. Këto janë shifra, por janë më shumë sesa shifra. Janë të gërvishura në xhepat e tyre të boshatitura dhe në tavolinat e tyre të zbrazura. Të

cosh sot një fëmijë në universitet është e papërbalueshme. Propozimet e PD për zgjidhjen e kësaj krize të shkaktuar nga krimi korruptiv; së pari; fasha e studenteve që vinë nga familje poshtë 640 mijë lekë në muaj, të përfitojnë nga tarifën e arsimit të lartë. Efekti buxhetor do të jetë afër 6 mln dollarë. Fasha e dytë janë ato familje me mbi 640 mijë lekë

me të ardhura në muaj. 18 mln dollarë Edi Rama i ka paraqitur në buxhetin e shtetit për shpenzimet e luksit. Dyfishimi i buxhetit nuk mjafton, pasi duhet një reformë e thellë. PD ka një platformë që do ta diskutojë me pedagogët dhe studentët. Para ka, por i duan për vetë", tha Basha. Ai akuzoi: "Para ka, por hajdutët i duan vetëm për vetë".

#### SHKURTE

##### Protestuesit bllokojnë rrugën, deputetët "izolohen" në parlament

Të mbështetur nga qytetarë të shumtë, student të shumtë protestuan dje para parlamentit ku mbahej seanca plenare. Ata vijuan thirrjet e tyre për plotësimin e tetë kërkesave. Në protestë u bashkuan edhe bluzat e bardha, të cilët protestuan në mënyrë të heshtur. Në shenjë revolte për moslejimin e organizimit të protestës së tyre të enjten para QSUT, ata qëndruan pranë studentëve me pankartën "Solidarizim me bluzat e Bardha që nuk mund të flasin". Ata kishin mbyllur gojën simbolikisht me para, duke treguar pamundësinë për të reaguar. Studentët thirrën me megafon: "Bëj ç'të duash, nxirri nga xhepi yt, apo ku i ke futur dhe plotësi 8 kërkesat tona. Nuk ka vend as për dialog e as për negociatë. Ju keni për detyrë të bëni më të mirën për ne sepse ju paguhemi me taksat tona. E bërë dialog me studentët, por nuk ke zgjidhur asgjë. Ke bërë dialog me minatorët, por nuk ke mbajtur fjalën. Ke bërë dialog me ish të përndjekurit politikë por nuk ke mbajtur fjalën. Nuk ta kanë besën aspak".

##### Monika Kryemadhi: Zyshtë Nikolla është dundur me ilaçe

Kryetarja e LSI, Monika Kryemadhi, nga foltorja e Kuvendit e çlësoi kryeministrin Rama si të sëmurë mendor, ndërsa tha se opozita propozon që të plotësohen kërkesat e studentëve pasi nuk u kushton shumë. "Sot nga kjo foltore, e cila është kapur peng nga një i sëmurë, me probleme të karakterit dhe mendjes, dua të them se amendamentet tona nuk kanë të bëjnë se kemi ndonjë besim të madh tek ky mbrapa apo atij që është atje duke bërë cirk me studentët, ishte për të thënë që nuk është më në dorën tonë, por në dorën e një të çmenduri. Ne dhe ju të PS duhet t'ju kërkojmë kartelën shëndetësore çdo njeriu që drejton këtë vend. Mua më vjen keq për zyshtë time Nikolla, e cila është dundur me ilaçe, sepse nuk po e përballon dot presionin, sepse nuk mban dot peshën e studentëve dhe të lëshojë karrigen që nuk do Edi, apo nuk i do Edi Edit. Prandaj në themi që të plotësohen ato 8 kërkesat", -tha Kryemadhi.





Deputeti Endri Hasa qëllloi disa herë me vezë në drejtim të kryeministrit

# Tension në Kuvend/ Opozita shpëton mandatet, Rama qëllohet me vezë

Deputeti demokrat përjashtohet me 10 ditë

Rikthimi i opozitës në Kuvend ka risjellë dhe sherret e debatet e forta në seancën plenare. Pas një breshëri fjalësh të rënda të kryetarit të Partisë Demokratike, Lulzim Basha, që morën shkas nga propozim i pazakontë i kryetarit të grupit parlamentar të PS-së për të futur në seancë plenare amendamentet për Kodin Zgjedhor pa kaluar më parë në komisionin e posaçëm, fjalën e ka marrë kryeministri Edi Rama. Por që në nisje të fjalës, ai ka provokuar opozitën teksa ka ironizuar kthimin e saj në sallë duke shpëtuar mandatet e saja. "Zyrtarisht grupi më ka dhënë 40 minuta për të folur, por unë minutat e mia do ia fal kryetarit të opozitës, që është kthyer sot jo me mandatet e pjekura, por jo të djegura. Unë vetë do të vazhdoj dialogun e vështirë me studentët...", - do të shprehej Rama, teksa do të ndërpritej nga disa goditje me vezë nga deputeti demokrat, Endri Hasa. Rama është gjetur i papërgatitur për këtë sulm me vezë, teksa njëra prej tyre e ka kapur në pjesën e krahorit, ndërsa më pas të tjerave, ai ka mundur t'ju shmanget. Teksa ka qëlluar me vezë, deputeti demokrat i është drejtuar Ramës me fjalët: "E ke nga studentët". Menjëherë kanë ndërhyrë forcat e sigurisë, të cilat kanë penguar deputetin Hasa që të vijojë sulmin e vet, ndërsa kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi, u detyrua ta përjashtojë atë nga seanca dhe të ndërpresë për disa minuta seancën. Por, edhe gjatë kohës që seanca ka qenë e ndërprerë, deputetët e opozitës kanë vijuar të sulmojnë me tufa letre kryeministrin, i cili qëndronte ende në foltore. Pas disa minutash, kryetari i Kuvendit ka rihapur seancën, por deputeti Hasa qëndronte prapë në sallë së bashku me kolegët e tjerë. Pasi i ka kërkuar sërish të largohet nga sala, Ruçi ka lajmëruar mbledhjen e Byrosë së Kuvendit për të marrë masë ndaj deputetit Hasa, duke ndërprerë edhe një herë seancën. Byroja me shumicë votash vendosi përjashtimin e Hasës për 10 ditë nga punimet e Kuvendit dhe menjëherë pas saj, Ruçi ka rihapur edhe një herë se-



Kryeministri Edi Rama, dje gjatë tensionit në parlament



**Balla: Vezët në Kuvend i futi Basha, i kishte fshehur në xhup**

Kryetari i grupit parlamentar të PS-së, Taulant Balla, deklaroi dje se vezët me të cilat deputeti demokrat, Endri Hasa qëlloi kryeministrin Edi Rama ishin fshehur nga Lulzim Basha brenda xhaketes, të cilat më pas ia ka dhënë deputetit. Përmes një postimi në "Facebook", të cilin e shoqëroi edhe me video, ku transmetoheshin pamje nga kamerat e brendshme të sallës së seanceve plenare, Balla shprehet se është e turpshme se si një kryetar opozite degradon deri në pikën që të fshehë nën puplat e shtrënjta të xhupit të tij dy vezë. "Artist! Po ti qenke edhe regjisor, edhe skenarist. U deshën 6 muaj që 'pula' Lulzim të prodhonte 2 vezë. E turpshme si një kryetar opozite degradon deri në pikën që të fshehë nën puplat e shtrënjta të xhupit të tij. Shikoni videon sesi artisti Lulzim bën qesharak rikthimin e opozitës në Kuvend. Është Lulzim Basha që 'prodhon' vezët dhe ia jep deputetit pa emër", shkroi Basha. Nga video dallohet që Endri Hasa i afrohet tavolinës ku qëndron Basha dhe diçka shkëmbejnë mes tyre, por nuk dallohet qartë nëse ai ka marrë vezët prej tij. Sipas Ballës, Basha ishte i vetmi nga deputetët demokrat që nuk iu nënshtrua kontrollit fizik gjatë hyrjes në Kuvend.

përdorur dhe provokimin që i kishte bërë opozitës. Pas kësaj, seanca është ndërprerë për disa orë, pasi deputetët demokratë vendosën të ngujoheshin së bashku me deputetin Hasa në sallë, duke mos lejuar funksionimin normal të saj. Në këto kushte kryetari i Kuvendit ka shtyrë punimet për orë e pasdites.

## Padia



### BALLA PADIT ENDRI HASËN

Kreu i grupit parlamentar të PS, Taulant Balla tha në seancën plenare të kësaj pasdite se do të kallëzojnë penalisht deputetin demokrat Endri Hasa. "Do i kërkoja PD të kërkojë ndjesë për aktin e turpshëm dhe dua t'ju informoj që do të depozitojmë një kallëzim penal për goditje për shkak detyre ndaj deputetit Endri Hasa", - tha Balla.

### ISH-KRYEMINISTRI



**Berisha: Vezët vinin nga Surreli, ishin kartolinë për Ramën**

Ish-kryeministri Sali Berisha komentoi dje veprimin e deputetit të PD-së, Endri Hasa, i cili qëlloi me vezë kryeministrin Edi Rama në foltoren e Kuvendit si shenjë revolte ndaj sjelljes së tij për studentët. Berisha tha se ai veprim ishte kartolinë për Vitin e Ri dhe Krishtlindjet që studentët i dërgonin Edi Ramës. "Kartolina e Krishtlindjes dhe Vitit të Ri që i dërgoi kryekumbarit dhe kreut të krim-it të organizuar, Edvin Rama. E vërteta është se ato vezë vinin direkt nga Surreli", - tha Berisha.

### KRYEMINISTRI

**Rama: Një trim kotecesh solli konfliktin e rrugës në Kuvend**

Kryeministri Edi Rama nëpërmjet një fjale të transmetuar nëpërmjet ERTV komentoi edhe sulmin që iu bë në sallën e parlamentit, duke e quajtur deputetin Endri Hasa si një trim koteci. "Ishim sot në parlament për të diskutuar për studentët me opozitën. Një trim kotecesh u çua për në foltore kur flisja unë duke nxjerrë nga xhupi vezë në përpjekje për të më qëlluar mua. Kështu debati mbaroi duke u kthyer në një konflikt rruge. Opozita bllokoi debatin që e kërkoi vetë", tha Rama e më pas nisi të tregoi fjalën e tij që kishte përgatitur të mbante në seancë. Më tej, kreu i qeverisë tha se të gjithë vëmendjen e tij e ka përqendruar tek studentët dhe dialogu me ta. Gjithashtu, ai nuk ka nguruar të sulmojë dhe dy kundërshtarët e tij politikë, Lulzim Basha e Monika Kryemadhi.

## PRESIDENTI VENDIMI

Presidenti çon për rishqyrtim në Kuvend një nga ligjet e paketës fiskale

# Meta kthen ligjin për Tatimin: Përmbys barazinë fiskale

"Favorizon shtresën më të pasur të shoqërisë"

Valentina Madani

Pas buxhetit të shtetit, Presidenti i Republikës, Ilir Meta ktheu dje për rishqyrtim në Kuvend një nga ligjet më të rëndësishme të paketës fiskale, atë "Për Tatimin mbi të Ardhurat". Sipas kreu të shtetit, nenet 9 dhe 11 bien në kundërshtim me parimin kushtetues të "barazisë përpara ligjit" dhe krijon pasiguri juridike për sa i takon aplikimit të tij në praktikë. Në gjykimin e z.Meta, ky nen krijon pabarazi fiskale për të gjithë ata që gjatë gjithë këtyre viteve e kanë shpërndarë dividendin deri në vitin 2017, me një normë tatimi fitimi 15%, ndërsa ata që nuk e kanë ndarë, do të përfitojnë një lehtësim fiskal duke paguar vetëm 8%. Kreu i shtetit shprehet se neni 11 bie ndesh me Kushtetutën, sa i takon hyrjes në fuqi të këtij ligji. Në përfundim, Meta nënvizon se ky ligj përmbys sistemin dhe barazinë fiskale, duke e kthyer sistemin e taksimit progresiv në regresiv, sepse favorizon ndjeshëm shtresën më të pasur të shoqërisë. Presidenti i Republikës i kërkon Kuvendit të rishqyrtojë këto dy nene, me qëllim që ato të mos bien ndesh me parashikimet Kushtetuese, ku përfutjesit realë të lehtësirave fiskale të parashikuara në këtë ligj, të jenë të gjithë qytetarët shqiptarë dhe biznesi, pa diferencime dhe me trajtim të barabartë. Propozimi i qeverisë për uljen e tatimit mbi dividendin është konsideruar si shkelje e barazisë para ligjit. Në draft thuhet se ky tatim nga 15 për qind shkon në 8, por duke përfshirë edhe fondet e pashpërndara të kompanive prej vitit 2017. "Nisur nga përkufizimi i nenit 9, del qartazi se kemi të bëjmë me një dispozitë ligjore me efekt prapaveprues, në trajtën e një 'amnistie fiskale', ku nuk përcaktohet qartë shtrirja kohore e saj. Në këtë mënyrë, krijohet pabarazi fiskale në raport me individët, apo aksionerët, të cilët



Presidenti i Republikës, Ilir Meta

### NENET

Sipas kreu të shtetit, nenet 9 dhe 11 bien në kundërshtim me parimin kushtetues të "barazisë përpara ligjit" dhe krijon pasiguri juridike për sa i takon aplikimit të tij në praktikë.

### KTHIMI I LIGJIT, ARGUMENTET E PRESIDENTIT META

- Neni 9, i ligjit nr.94/2018, bie në kundërshtim me parimin kushtetues të "barazisë përpara ligjit" dhe krijon pasiguri juridike përsa i takon aplikimit të tij në praktikë. Nisur nga përkufizimi i nenit 9, del qartazi se kemi të bëjmë me një dispozitë ligjore me efekt prapaveprues, në trajtën e një "amnistie fiskale", ku nuk përcaktohet qartë shtrirja kohore e saj. Neni 9 i ligjit nr.94/2018, është në kundërshtim të hapur me parashikimet e nenit 15 të Kushtetutës, i cili ndalon trajtimin fiskal preferencial me efekt prapaveprues. Neni 9 krijon pabarazi fiskale në raport me individët, apo aksionerët, të cilët gjatë gjithë këtyre viteve e kanë shpërndarë dividendin deri në vitin 2017, duke zbatuar një normë tatimi prej 15%, ndërkohë që me neni 9 të ligjit të miratuar, aksionerët, të cilët nuk e kanë shpërndarë dividendin deri në 2017, tashmë do të përfitojnë një lehtësim fiskal, duke aplikuar një tatim fitimi prej 8%. Neni 9 krijon paqartësi dhe mundësi abuzivizmi ndaj bizneseve dhe aksionerëve për shkak se nuk përcakton saktësisht normën 8% apo 15%, si dhe mënyrën se si do të tatohet dividendi që i përket fitimeve të pashpërndara të viteve 2017 dhe më parë, në rast se subjekti tregtar nuk e respekton apo e tejkalon afatin e parashikuar në këtë nen për pagesën e tatimit mbi dividendin (30 shtator 2019) dhe është në kushtet kur nuk ka marrë një vendim për shpërndarjen e dividendit, për periudhën e diktuar nga ligji.
- Neni 11, i ligjit nr. 94/2018, bie ndesh me parashikimet e nenit 84 pika 3 të Kushtetutës, përsa i takon afatit të hyrjes në fuqi të këtij ligji. Neni 11, i ligjit nr. 94/2018 të miratuar dhe të paraqitur për dekretim dhe shpallje, parashikon se: "Ky ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2019". Në këtë mënyrë, kjo dispozitë bie ndesh me parashikimet e nenit 84 pika 3, të Kushtetutës që diktojnë detyrimin që ligji duhet të hyjë në fuqi jo më parë se 15 ditë nga botimi i tij në Fletoren Zyrtare. Referuar kërkesave të Kushtetutës është objektivisht e pamundur që ligji nr. 94/2018, të hyjë në fuqi më datën 1 janar 2019.

gjatë gjithë këtyre viteve e kanë shpërndarë dividendin deri në vitin 2017, duke zbatuar një normë tatimi prej 15%", argumenton presidenti. Madje, në analizën e materialit shtohet se referuar statistikave të bëra publike nga Ministria e Financave, në vitet e fundit kemi një reduktim drastik të vlerës së arkëtuar nga tatimi mbi dividendin. "Rrjedhimisht është logjike që nisur nga

këto pritshmëri, korporatat duket se kanë zgjedhur të shtojnë në kohë shpërndarjen e fitimit në një moment të përshtatshëm, kur tatimi mbi dividendin do të ulej ndjeshëm", argumenton presidenti. Efekti pozitiv sipas relacionit të qeverisë mbi ligjin pritet të jetë rreth 40 milionë \$.

Së fundi, kreu i shtetit shprehet se ligji përmbys sistemin e barazisë fiskale, sepse favorizon ndjeshëm shtresën më të pasur të shoqërisë. Praktikisht, tatimi mbi të ardhurat personale për pagën mbetet i pandryshuar si normë, në nivelin deri në 23%, ndërsa aksionerët e korporatave dhe kompanive të mëdha propozohet të paguajnë vetëm 8%. Ky është ligji i dytë që Meta kthen brenda pak ditësh. Pak ditë më parë presidenti ktheu projektbuxhetin e vitit 2019.



Kryeministri Edi Rama, dje me studentët e Universitetit Politeknik

### "Kryemadhi zgjoi Prokurorinë shqiptare"

Banorët e Unazës së Re në protestë: Edi Rama të tërheqë projektin

Banorët e Unazës së Re u mbledhën sërisht mbrëmjen e djeshme për të protestuar kundër projektit korruptiv dhe klientelist të kryeministrit Edi Rama. Ata i bënë sërisht thirrje kryeministrit Rama që të tërhiqet nga ky projekt dhe se ata nuk do të lejojnë askënd që t'u prishë shtëpitë. Në mbështetje të banorëve të Unazës së Re shkuan edhe deputetë e opozitës. Banorët e Unazës së Re falënderuan kryetaren e Lëvizjes Socialiste për Integrim, Monika Kryemadhin, për mbështetjen e vazhdueshme që u ka dhënë në kauzën e tyre. Sipas protestuesve, falë këmbënguljes së vazhdueshme të Monika Kryemadhit, prokuroria nisi hetimit për superskandalin e megavjedhjes që po bëhej tek Unaza e Madhe. "Falënderojmë Kryemadhin për mbështetjen që na ka dhënë duke vënë në lëvizje Prokurorinë. Kemi besim të kryetarja e LSI, e cila e ka treguar mbështetjen në vite për këtë zonë", u shprehën banorët. PD akuzoi dy ditë më parë se në zonën e Unazës së Madhe po parashikohet ndërtimi i blloqeve të pallateve, të cilat i ka në një dorë si projekt biznesmeni Edmond Bego, konfirmohen edhe nga firma projektuese italiane "MISALAB". Në faqen e vet "online", firma italiane e titullon projektin "Tiran Splendor" dhe e përshkruan atë si një projekt që do të realizohet në një zonë në perëndim të Tiranës, që është pjesë e një programi të një transformimi të fortë urban. Bëhet fjalë për 100 mijë m<sup>2</sup> sipërfaqe rezidenciale, dy sheshe këmbësorësh me shërbime dhe një qendër tregtare 11 mijë m<sup>2</sup>. Në faqen "online" saktësohet se posoritësi është kompania "INerte Express", vlera është 60 milionë euro dhe se fillimi i punimeve është parashikuar për në tetor të vitit 2018.




### FALËNDERIMI

Banorët e Unazës së Re falënderuan kryetaren e Lëvizjes Socialiste për Integrim, Monika Kryemadhin, për mbështetjen e vazhdueshme që u ka dhënë në kauzën e tyre.





 Tirana International Airport  
Nënë Tereza

**TENDER NOTIFICATION**

**CONSULTING SERVICES FOR CONSTRUCTION MANAGEMENT  
"AIRFIELD 2020" PROJECT  
TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT**

Tirana International Airport sh.p.k (TIA) is requesting offers for consulting services for construction management of "Airfield 2020" project.

TIA is looking to contract a company that will provide the consulting services which consist of technical and administrative assistance and support on behalf of TIA for monitoring, managing and supervising the construction works that will be part of the "AIRFIELD 2020" PROJECT.

To participate in this process interested parties will need to submit their interest for participation by e – mail, to all below e – mail address.

Upon receipt of the e – mail, TIA will send to the respective company a Confidentiality Commitment form. The interested company will need to send the signed and stamped Confidentiality Commitment form, by e-mail, at all the e – mail address below, and only then they will receive all the necessary forms and instructions for participating in this tender.

The set of tender documents will be delivered free of charge, via e-mail.

Offers need to be submitted in a **closed and sealed package** clearly marked: "CONSULTING SERVICES FOR CONSTRUCTION MANAGEMENT" "AIRFIELD 2020" PROJECT

The address for submission of offers is:

**Tirana International Airport sh.p.k**  
Administration Building  
Rinas, Tirana  
Albania

The deadline for the submission of offers at the above address is **12:00 hrs. on 11 January 2019.**

Any offer submitted by open means (e.g. by e-mail, fax) will not be considered for this tender.

For further information please send an email to all following addresses:  
ialimema@tirana-airport.com; lvojka@tirana-airport.com; apalushi@tirana-airport.com

**BalkanWeb.com**

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.  
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,  
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



**MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ  
CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET**



**INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET  
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR  
QR CODE APPLE DHE ANDROID**



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

**SHPLLJE E VENDEVE VAKANTE**

Kolegji i Posaçëm i Apelitit (KPA) pranë Gjykatës Kushtetuese, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelitit", i ndryshuar me vendimin nr.101 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelitit".

**1. Rishpall 2 (dy) vende vakante për "Specialist IT" në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse.**

**KËRKESAT E POSAÇME TË POZICIONIT TË PARË PËR "SPECIALIST IT":**

- Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Inxhinieri Informatike, Informatike, Teknologji informacioni etj.
- Të ketë të paktën 3 vite eksperience pune në fushën e teknologjisë së informacionit.
- Të ketë eksperiencë në menaxhimin e projekteve TIK.
- Të ketë eksperiencë në hartimin e politikave të brendshme IT dhe planifikime ne fushen IT.
- Të ketë njohuri shumë të mira për infrastrukturën e IT dhe sistemet të cilat implementohen mbi to.
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

**KËRKESAT E POSAÇME TË POZICIONIT TË DYTË PËR "SPECIALIST IT":**

- Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Inxhinieri Informatike, Informatike, Teknologji informacioni etj.
- Të ketë të paktën 3 vite eksperience pune në fushën e teknologjisë së informacionit.
- Të ketë njohuri shumë të mira në administrimin e sistemeve si Active Directory, Outlook Mail Client
- Të ketë njohuri bazë mbi pajisjet e rrjetit dhe infrastrukturën e rrjetit.
- Të ketë njohuri bazë për panelet e administrimit të faqeve web (Wordpress, Drupal, Joomla etj).
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

**2. Shpall 1 (një) vend vakant për "Specialist Financë/Buxheti" në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse.**

**KËRKESAT E POSAÇME TË POZICIONIT "SPECIALIST FINANÇË/BUXHETI":**

- Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Ekonomi, Dega Financë.
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- Të ketë të paktën 5 vite përvojë pune në profesion.
- Të ketë njohuri në programet financiare si: Alpha/Financa 5 etj.

**3. Shpall 1 (një) vend vakant për "Specialist i Burimeve Njerëzore" në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse.**

**KËRKESAT E POSAÇME TË POZICIONIT "SPECIALIST BURIME NJERËZORE":**

- Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor".
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në fushën e burimeve njerëzore.

**KUSHTE TË PËRGJITHSHME:**

- Kandidatët duhet të sigurohen se plotësojnë kriteret për të pajisur me Certifikatë Sigurie, sipas Vendimit Këshillit Ministrave nr.188, datë 4.3.2015.
- Kandidatët duhet të kenë aftësi për të përshtatur e punuar në grup, nën presion si dhe në afate kohore të limituara.

**Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 20 dhjetor deri më 31 dhjetor 2018 në një nga format e dhëna më poshtë:**

- Paraqitjes së Kërkesës nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të KPA-së, në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Nr. 3, Tiranë, nga e Hëna në të Premte, ora: 09:00-16:00.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë institucionit të KPA-së në adresën: "Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Nr. 3, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 31 dhjetor 2018, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatit e lëshuar nga institucioni përkatës postar. KPA-ja do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data 20 dhjetor deri më 31 dhjetor 2018 në adresën info@kpa.al. KPA konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

- Jetëshkrim profesional në gjuhën shqipe, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
- Kopje të dokumentave (diplomë, letërnjoftimi (ID), librezë pune) original ose të noterizuar. Diplomën që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;
- Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal;
- Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore ne fuqi;
- Vlerësimin e fundit nga Eprori Direkt;
- Cdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnimin, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

**Kandidatët të cilët aplikojnë nëpërmjet postës elektronike, nëse do të vlerësohen që plotësojnë kriteret ligjore, duhet të paraqesin ditën e intervistës dokumentet origjinale ose të njësuara me origjinalin, që vërtetojnë kushtet e parashikuara sipas pikave 1-7.**



Dëbimi i ambasadorit të Iranit nga Shqipëria, presidenti amerikan: Bashkë kundër terrorizmit

# Trump, letër Ramës: Treguat leadership

"Shqipëria, mike e madhe e SHBA, mirëpres rritjen e partneritetit"

Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump, i ka dërguar një letër kryeministrit Edi Rama pas dëbimit të ambasadorit iranian në Tiranë dhe një diplomati tjetër, të cilët akuzohen për komplete terroriste brenda vendit tonë. Letra është bërë publike nga ambasada amerikane në Tiranë, e cila përgëzon qeverinë shqiptare për veprimet kundër regjimit iranian. Ambasada shpreh mbështetje për Shqipërinë, duke e cilësuar aleat strategjik. Ndërsa në letërën e tij, Presidenti Trump falënderon kryeministrin Rama dhe shkruan se "udhëheqësia e treguar me dëbimin e ambasadorit të Iranit nga vendi juaj është shembull i përpjekjeve tona të përbashkëta për t'i treguar qeverisë iraniane se veprimet e saj terroriste në Evropë dhe përrreth botës do të kenë pasojë të rënda".



Faksimile e letres se Presidentit te Shteteve te Bashkuara te Amerikes, Donald Trump, qe i ka derguar kryeministrin Edi Rama

Më tej, presidenti amerikan shpreh në letërën e tij për kryeministrin se Shqipëria ka qenë gjithmonë një mike e madhe e Shteteve të Bashkuara dhe se mirëpret rritjen e partneritetit tonë. "E përgëzojmë Qeverinë e Shqipërisë për arsye se ndërmori veprime kundër regjimit iranian për komplotin e tij terrorist në tokën shqiptare, duke kërcënuar sigurinë evropiane. Qeveria e Shqipërisë ka treguar udhëheqësi të vërtetë në përpjekjet tona të përbashkëta për t'i dërguar një mesazh të qartë Iranit se kryerja e veprimeve terroriste në Evropë, apo kudo tjetër, është e papranueshme dhe nuk do të tolerohet. Ne qëndrojmë krah për krah me Shqipërinë, aleatin tonë në NATO dhe partnerin tonë strategjik. Në vijim gjëmi letërën e Presidentit Donald Trump në të cilën falënderohet Qeveria e Shqipërisë."

"I dashur Z. Kryeministër: Faleminderit për përpjekjet tuaja të palëkundura, duke iu kundërvënë Iranit dhe duke iu kundërpërgjigjur veprimeve e përpjekjeve të tij destabilizuese për t'u mbyllur gojëni disidentëve anembanë globit. Udhëheqësia e treguar nga ju me dëbimin e ambasadorit të Iranit nga vendi juaj është shembull i përpjekjeve tona të përbashkëta për t'i treguar qeverisë iraniane se veprimet e saj terroriste në Evropë dhe përrreth botës do të kenë pasojë të rënda. Shqipëria ka qenë gjithmonë një mike e madhe e Shteteve të Bashkuara dhe unë mirëpres rritjen e partneritetit tonë, ndërsa ballafaqohemi me çështjet e shumta të rëndësishme që të dyja

vendet tona hasin. Singërisht, Donald Trump".

Shqipëria ka shpallur persona të padëshiruar (non grata) ambasadorin e Republikës Islamike të Iranit në Tiranë, Gholamhossein Mohammadnia si dhe një zyrtar tjetër të ambasadës, pasi dyshohet se janë përf-

shirë në aktivitete që cenojnë sigurinë në vend. Burime nga MEPJ bënë me dije për "BalkanWeb" se vendimi i Shqipërisë për shpalljen e ambasadorit iranian dhe zyrtarit tjetër si të padëshiruar është marrë në konsultim me vendet aleatë, për shkak të aktivitetit të tyre në Shqipëri

në kundërshtim me statusin e tyre diplomatik. Për dëbimin e ambasadorit iranian nga Shqipëria dhe një zyrtari tjetër të ambasadës reagoi edhe këshilltari për sigurinë i Presidentit Trump, John Bolton, i cili ka shprehur mbështetje për kryeministrin Edi



### SHPALLJA NON-GRATA

Shqipëria shpalli persona të padëshiruar (non grata) ambasadorin e Republikës Islamike të Iranit në Tiranë, Gholamhossein Mohammadnia si dhe një zyrtar tjetër të ambasadës, pasi dyshohet se janë përfshirë në aktivitete që cenojnë sigurinë në vend.



### REAGIMI I NETANJAHUT

"Lajme të rëndësishme nga Shqipëria sot. Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka dëbuar ambasadorin iranian nga Tirana. Me këtë, kreu i qeverisë, Rama i ka dërguar një mesazh të qartë regjimit radikal islamik të Iranit, që komplotet e sulmeve terroriste e kanë një kosto", shkruan Netanjahu.

Rama dhe populli shqiptar në qëndresën kundër terrorizmit. Po kështu, mbremjen e kaluar edhe Sekretari Amerikan i Shtetit, Mike Pompeo ka përsëritur vendimin e Shqipërisë për të dëbuar ambasadorin iranian në Tiranë si dhe një punonjës tjetër, që akuzo-

hen se komplotuan sulme terroriste në Shqipëri. Pompeo shkruante se përgëzon vendimin e kryeministrit Edi Rama për dëbimin, ndërsa sipas tij bota duhet të qëndrojë e bashkuar ndaj sanksioneve të Iranit, në mënyrë që të ndryshojë sjellje.

## "Hap i nevojshëm për t'iu kundërvënë terrorizmit dhe diktaturës"

### Muxhahedinët, Rajavi: Dëbimi i ambasadorit të Iranit, akt i guximshëm i qeverisë "Rama"

Znj. Maryam Rajavi, presidentja e zgjedhur e Këshillit Kombëtar të Rezistencës së Iranit, e ka mirëpritur përjashtimin e ambasadorit të regjimit iranian dhe të shefit të stacionit të Ministrisë së Inteligjencës në Shqipëri. Ajo e ka përshkruar këtë akt të guximshëm si një hap të nevojshëm për t'iu kundërvënë terrorizmit dhe diktaturës fetare që sundon Iranin, si dhe një domosdoshmëri për sigurinë e vendeve evropiane.

Prillin e shkuar, kryeministri Edi Rama pati shpallur se ishte parandaluar një komplot terrorist i kurdisar nga regjimi klerikal kundër organizatës muxhahedine të popullit të Iranit (PMOI/MEK). "Ne jemi në anën e duhur të historisë. Jemi me vendeve evropiano-atlantike, të cilat gjenden nën të njëjtin kërcënim. Besoj se të gjitha këto vende do

të veprojnë kundër kërcënimeve terroriste", pati deklaruar z. Rama më 19 prill 2018. Gholamhossein Mohammadnia, ambasadori i regjimit në Shqipëri dhe Mostafa Roudaki, shefi i stacionit të Ministrisë së Inteligjencës (MOIS) në atë shtet, janë të dy zyrtarë të lartë të MOIS, të cilët u ekspozuan nga Rezistenca Iraniane në vitet 2016 dhe 2017. Mohammadnia ishte përfaqësuesi i MOIS në delegacionin e kryesuar nga ministri i Jashtëm i regjimit, Javad Zarif, gjatë bisedimeve përthamore që çuan në krijimin e paktit përthamor me Iranin, i njo-

hur si Plani i Përbashkët Gjithpërfshirës i Veprimit (JCPOA). Në letërën e tij më të fundit, Presidenti i Shteteve të Bashkuara ka falënderuar qeverinë e Shqipërisë për "përpjekjet e saj të patundura për të ngritur krye ndaj Iranit e për t'iu kundërvënë veprimtarive të tij destabilizuese dhe përpjekjeve për të heshtur disidentët në mbarë globin". Znj. Rajavi tha se mullahëve që sundojnë Iranin duhet t'u tregohet se, "veprimtaritë e tyre terroriste në Europë e në mbarë botën do të kenë pasojë serioze". Ajo shtoi: "Që tre dekada më parë, Rez-



Maryam Rajavi, presidentja e zgjedhur e Këshillit Kombëtar të Rezistencës së Iranit

istenca Iraniane e ka theksuar gjithmonë se Ministria e Jashtëm e regjimit iranian dhe diplomatët e ambasadat e saj janë pjesë thelbësore e makinerisë së terrorizmit të regjimit. Tri komplete të mëdha terroriste nga mullahët në Shqipëri në mars 2018, në Francë në qershor 2018 dhe në Danimarkë në shtator 2018 kanë qenë të planifikuara nga këto ambasada e diplomatë". "Regjimi klerikal e ka gjetur të vetmen rrugëdalje nga krizat e ngërçet e pandreqshme të brendshme e të jashtme në shtypjen e popullit të Iranit, luftënxitjen në rajon,

kërcënimet me raketa, si dhe në shpërndarjen e lajmeve të rreme, denigrimin dhe terrorizmin, veçanërisht kundër Rezistencës Iraniane, të cilën e sheh si një kërcënim ekzistencial", tha znj. Rajavi, duke shtuar, "regjimi në Teheran është kumbari dhe epiqendra e terrorizmit nën flamurin e Islamit në botën e sotme. Për këtë arsye, etiketimi i Ministrisë së Inteligjencës si një entitet terrorist dhe përjashtimi i diplomatëve terroristë të mullahëve nga SHBA dhe Europa është i domosdoshëm për sigurinë e këtyre vendeve dhe kërkohet gjithashtu nga populli iranian".

**Njoftim për shitje me ankad të dytë**

Shqipëria "Power & Justice" (P&J) sh.p.k. bazuar në adresën 577, 568 të K. Pr. Cille ka shpallur shitjen me ankad të dytë për pasurinë e paluajtshme të palës debitore SH "Eksports Beton Lezhe" sh.p.k. etj.

"Tokë Aë" nr. Z. K. 1987 me numër pasurie 3038 Volumni 19 Faqe 71, me sipërfaqe 1000 m2 me cmim fillëstar prej 58.016 Euro

"Tokë Aë" nr. Z. K. 1987 me numër pasurie 4056 Volumni 11 Faqe 92, me sipërfaqe 1730 m2 me cmim fillëstar prej 100.368 Euro

"Tokë Aë" nr. Z. K. 1987 me numër pasurie 2573 Volumni 15 Faqe 239, me sipërfaqe 2.000 m2 me cmim fillëstar prej 98.112 Euro

Rokandi-opsionit hapur për 15 ditë dhe do të zhvillohet në datën 14.01.2019 në orën 15.00, grana selidë në Bullevard "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kull 2, Zyrë nr. 5 Ofertuesit mund të kontaktojnë 067202543 dhe vizitojnë faqen WEB www.powerjustice.al.com.

Prokuroria kishte kërkuar dënimin me 1 vit heqje lirie për 24-vjeçarin

# "Xhisiela", Gjykata e Krujës liron nga burgu djalin deputetit socialist

Rexhep Rraja u dënua me 1 vit shërbim prove

KRUJË

Historia e bujshme mes Xhisiela Malokut dhe 24-vjeçarit Rexhep Rraja ka përfunduar me lirimin e këtij të fundit. Dje Gjykata e Shkallës së Parë e Krujës e ka dënua me një vit shërbim prove djalin e deputetit të Partisë Socialiste, Rrahman Rraja, për akuzën e përndjekjes ndaj të resë nga Fushë-Kruja. Trupi gjyqësor i kryesuar nga gjyqtarja Engjëllushe Tahiri vendosi të lirojë nga qelia Rexhep Rrajën, duke e dënua atë me 1 vit shërbim prove. Ndërkohë që Prokuroria e Krujës kishte kërkuar dënimin me një vit burg të të riut, edhe pse ai dhe Xhisiela Maloku kishin bërë një akt pajtimi te noteri, duke konfirmuar se nuk kanë konflikte me njëri-tjetrin. Në këtë masë dënimi, gjykata ka marrë parasysh faktin se ndaj Rrajës është zhvilluar gjykim i shkurtuar. Gjatë seancës së shkuar (u zhvillua me 13 dhjetor të këtij viti) ku u dha pretenca ishte e pranishme edhe ish-e dashura e Rrajës. Gjatë fjalës së saj, Xhisiela Maloku ka ripërsëritur faktin se nuk është dhunuar dhe përndjekur nga Rexhep Rraja. Ndërkohë, Gjykata e Krujës i la një javë kohë avokatit mbrojtës të të pandehurit për të përgatitur konkluzionet e mbrojtjes, para se të jepte vendimin përfundimtar. Me 28 nëntor, gjykata e Krujës ka pranuar kërkesën për gjykim të shkurtuar ndaj Rexhep Rrajës, për çështjen "Xhisiela". Në seancën e vlerësimit të kërkesës për gjykim të shkurtuar ishte e pranishme edhe 25-vjeçarja, e cila në këtë proces kishte statusin e së dëmtuarës. Mësohet se ajo ka deklaruar para gjyqtarës Engjëllushe Tahiri se ka gënjyer për të gjithë kallëzimin e saj. Edhe më herët, para policisë e gjykatave ku ka kaluar historia e tyre, vajza nga Fushë-Kruja ka deklaruar se gjithçka e kishte bërë për xhelozë, por që nuk ishte dhunuar. Në këtë linjë qëndroi edhe avokati i 24-vjeçarit të akuzuar. Avokati mbrojtës i Rrajës ka thënë se denoncimi nga Xhisiela Maloku është bërë vetëm për motive xhelozie. Rexhep Rraja u arrestua në 30 shtator, pasi gjykata e Krujës caktoi ndaj tij masën e sigurisë "Arrest me burg" në mungesë nën akuzën e përndjekjes, si finalizim i një dosjeje që kishte qenë në duart e prokurorisë prej disa muajsh. Çështja mori përmasa të tjera kur



24-vjeçari Rexhep Rraja



Xhisiela Maloku

**ARRESTIMI**

Rexhep Rraja u arrestua më 30 shtator të këtij viti, pasi ish-oficeri i policisë, Emiljano Nuhu denoncoi në media kërcënimet, sipas tij, nga disa eksponentë të PS-së, për të mbyllur denoncimin e Xhisiela Malokut. 25-vjeçarja i qëndroi deri në fund variantit se nuk është dhunuar nga Rexhepi, por denoncimet për dhunën e ushtruar i kishte bërë në korrik të këtij viti për shkak të xhelozisë. Çështja "Xhisiela" krijoi debate të forta politike, pasi opozita akuzoi deputetin Rrahman Rraja dhe deputetë të PS-së se i bënë presion policisë së Fushë-Krujës për ta mbyllur këtë dosje.

ish-oficeri i policisë, Emiljano Nuhu, denoncoi në media kërcënimet, sipas tij, nga disa eksponentë të PS-së për të mbyllur denoncimin e Xhisiela Malokut. Debatet dhe akuzat për këtë çështje përfshinë edhe politikën. Për këto akuzë, Prokuroria e Tiranës ka nisur një procedim të veçantë, ndërsa ish-oficeri i Policisë Gjyqësore në Fushë-Krujë, Emiljano Nuhu, pasi u dërgoi një letër autoriteteve më të larta në vend duke denoncuar rastin, kërkoi azil në Zvicër.

**PRETENCA**

Prokuroria e Krujës kishte kërkuar dënimin me një vit burg të 24-vjeçarit Rexhep Rraja, edhe pse ai i ka mohuar të gjitha akuzat dhe së bashku me ish-të dashurën e tij, Xhisiela Maloku kishin bërë një akt pajtimi te noteri, duke konfirmuar se nuk kanë konflikte me njëri-tjetrin. Në këtë masë dënimi gjykata e këtij rrethi ka marrë parasysh faktin se ndaj Rrajës është zhvilluar gjykim i shkurtuar. Gjatë seancës së shkuar (u zhvillua me 13 dhjetor të këtij viti) ku u dha pretenca ishte e pranishme edhe ish-e dashura e Rrajës, e cila ka ripërsëritur faktin se nuk është dhunuar dhe përndjekur nga Rexhep Rraja.

## "Ja pse u lirua i biri i deputetit mafioz"

### Vendimi për çështjen "Xhisiela", reagon PD: Provë e rënies së sistemit të drejtësisë

**TIRANË** - Pas lirimit nga burgu të Rexhep Rrajës, djali të deputetit socialist Rrahman Rraja, ka reaguar Partia Demokratike. Sipas PD-së, vendimi i Gjykatës së Krujës për lirimin e përdhunuesit Rexhep Rraja është një tjetër provë e rënies së sistemit të drejtësisë. "I biri i deputetit mafioz të Fushë-Krujës është lënë i lirë jo për t'i shërbyer komunitetit, por për t'i shërbyer pushtetit kriminal të Edi Ramës. Lirimi nga burgu i djalit përdhunues të deputetit socialist tregon standartin e dyfishtë të drejtësisë që kontrollon Edi Rama. Nga njëra anë



mbahen në burg qytetarët që nuk paguajnë dot dritat, nga ana tjetër lihen të lirë ata që vjedhin votat për Edi Ramën, përdhunuesit, vrasësit dhe trafikantët e drogës. Edi Rama nuk ka ndërmend të ndërtojë një

drejtësi më të mirë për shqiptarët, por një drejtësi që i shërben atij, ministrave të tij të korruptuar dhe kriminit të organizuar me të cilin vjedh votat dhe bashkëqeveris", thuhet në deklaratën e Partisë Demokratike.

**SHKURT**

**Tritol makinës së shoferit**

**të ambulancës në Orikum**  
**VLORË** - Një shpërthim i fuqishëm me tritol ka tronditur mbrëmë banorët e Orikumit. Mësohet se persona ende të paidentifikuar i kanë vendosur eksploziv makinës në pronësi të shtetasit Vezir Bello, i cili punonte si shofer ambulance në Orikum. Po ashtu, bëhet e ditur se mjeti ishte parkuar gjatë momentit kur ndodhi shpërthimi dhe se fatmirësisht janë shkakuar vetëm dëme materiale. Pas sinjalizimit, policia ka shkuar në vendngjarje dhe ka nisur hetimet.

**Protesta, lirohet nga qelia Dritan Protoduari**

**TIRANË** - Gjykata e Apelit liroi dje nga burgu Dorian Protoduarin, i cili u arrestua më 20 nëntor në Spitalin e Traumës, pas protestës së banorëve të Unazës së Re para parlamentit kundër prishjes së baneave të tyre. Mësohet se mbrojtja kërkoi rivlerësim të masës së sigurisë "Arrest me burg" të vendosur më herët ndaj tij. Trupi gjyqësor vendosi të lehtësojë masën e sigurisë, duke vendosur ndaj tij "Detyrim paraqitje".

**Tregtonte mish e bulmet pa licencë, pranga pronarit**

**TIRANË** - Policia e Tiranës ka arrestuar pronarin e një subjekti tregtar, pasi tregtonte produkte mishi e bulmeti pa licencë. Në pranga ka përfunduar 48-vjeçari me iniciale A.A., pronar i një subjekti. Ai akuzohet për veprat penale "Prodhimi i kundraligjshëm i mallrave dhe artikujve ushqimor", "Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë", "Ruajtja apo depozitimi i mallrave që janë kontrabandë". Ky subjekt u gjobit nga ana e AKU-së në shumën prej 1.650.000 lekë për shkeljet e konstatuara, ndërsa nga ana e Hetimit Tatumor në shumën prej 137.366 lekë, për mallra pa faturë të dyshuara si kontrabandë.

**Qëllohet me breshëri kallashi makina e parkuar**

**FIER** - Mbrëmjen e së mërkurës është qëlluar me breshëri kallashnikovoj një makinë në fshatin Zhupan të Fierit. Mësohet se automjeti tip "Benz", në pronësi të shtetasit A.B. ishte parkuar që prej 1 muaji pranë një karburanti në anë të rrugës Fier-Levan, pasi ishte nxjerrë në shitje. Menjëherë policia ka shkuar në vendngjarje dhe po punon për zbardhjen e plote të rrethanave, identifikimin dhe kapjen e autorit.

**NJOFTIM ANKANDI**

1. Shoqëria e Përmbartimit "BALIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k njofton Shpalljen e Ankandit të II (dytë), për shitjen e pasurisë ULLISHTE, me sip.3.400 m<sup>2</sup>. Zona Kadastrale: 1615 Numri i Pasurisë: 3271. Vol. 1, Fage 221, ndodhur në Fier-Shegan Lushnje, në pronësi të: Z.Bajram Selfer Sivrag. i datëlindjes 14.11.1967. Ankandi i pasurisë fillon me çmimin fillestar në vlerën **1.995.000 (një milion e nëntëqind e katër mijë) LEKË.**

Ankandi do të zhvillohet më datë **16.01.2019, ora 16:00**, pranë zyrës së Shoqërisë së Përmbartimit "BALIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k, në adresën Rruga "Vaso Pasha" Pallati 13/1, Ap.1, Tiranë, nr.tel:042320227, email: [alvith@hotmail.com](mailto:alvith@hotmail.com).

**NJOFTIM SHITJE ME ANKAND**

**ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE "ILIA ELEZI"**

PASURIA nr. 1/358, e llojit "Tullai dhe Ndërtesë" (godinë banimi dhe shërbime 3 kate e ndodhur në Ish-Fushën e Avianicimit) me sipërfaqe të tullalit 273m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtimi prej 200.2m<sup>2</sup>. Zona Kadastrale 6220, Vol. 23, Fq. 28, e regjistruar në Regjistrin Hipotekor Nr. 18, datë 07.01.2011 pranë Z.V.R.P.P TIRANË, në pronësi të Znj. DENKË SEFERI.

ÇMIMI **36.389.985.28 LEKË.** Data e zhvillimit të ankandit do jetë **02.01.2019.**

CEL: 0684026666 ; 0693262866.

**DOMINUS**

**Njoftim Shitje ne Ankand**

Shoqëria Përmbartimore "Dominus" Rruga "Sami frasheri"pili "Titan", kati trete Tiranë. cel 0692055122

Shitje ne ankand e e dyte te pasurise:Tokë Arë, Nr.Pasurie 104/16, ZK 3774, vol 3, faqe 141, e ndodhur në Vllë-Ballaj, Kavajë

Çmimi me të cilin fillon shitja e pasurisë në ankandin e dyte është 1.323.000 lekë (një milion e treqind e njëzet e tre mijë)

Ankandi do te zhvillohet ne daten **25.12.2018, ora 16.00.**



"Kriteret sesi do të bëhet përzgjedhja, ja pas sa muajsh do të futet në zbatim"

Voltiza Duro

Sot do të mbahet mbledhja e radhës së Këshillit Bashkiak të Tiranës ku pritet miratimi i listës fituese të 456 familjeve që do të përfitojnë shtëpi me kredi të butë. Ndërkohë, pritet të miratohet edhe lista e pritjes me 549 familjet që mund të përfitojnë nga ky program. "Komisioni vendosi se pjesa prej 549 familjeve të vendosen në listën e pritjes, e cila do të jetë e zbatueshme për rastet kur familjet e shpallura fituese nuk paraqiten, heqin dorë, nuk pranojnë dhe/ose refuzojnë që të lidhin kontratën përkatëse me institucionin financiar bankar të përzgjedhur nga Bashkia Tiranë"-thuhet në

# Shtëpitë me kredi të butë, zbardhen emrat e familjeve në listën e pritjes

## Kush janë 549 personat që mund të përfitojnë

projektvendim. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot listën me emrat e 549 familjeve që do të jenë në listën e pritjes e që mund të përfitojnë nga programi social "Subvencionimi i interesave të kreditës", për vitin 2018. Pas

shqyrtimit të dokumentacionit, rezultoi se nga 1082 aplikime, plot 1005 të tilla janë të rregullta dhe plotësojnë kriteret për përfitim e kreditës së butë për shtëpi. "77 aplikime janë skuallifikuar, nga të cilat 59 kanë

rezultuar të parregullta dhe/ose me mangësi në dokumentacion, 6 aplikime për shkak se të ardhurat familjare rezultojnë mbi limitin e përcaktuar në udhëzuesin operacional, dhe 12 aplikime kanë rezultuar nën limitin

e përcaktuar në udhëzuesin operacional", theksohet në projektvendim. Përkatesisht 36 persona kanë fituar garsonierë; 337 kanë fituar shtëpi 1+1 me kredi të butë; 81 të tjerë do të marrin shtëpi 2+1 dhe vetëm dy familje

do të paguajnë një shtëpi 3+1 me kredi të butë. Familjet përfituese do të kenë një afat prej 4 muajsh, i cili fillon nga momenti i njohimit që do të kryejë Bashkia Tiranë, që të paraqiten pranë bankës për lidhjen e kontratës.

### PERSONAT QË MUND TË PËRFITOJNË KREDI TË BUTË

Nr.	Nr. Rendor	Emer	Atesia	Mbiemer	Pikezimi	Struktura	Shuma qe përfiton								
1	250	Sabri	Sefedin	Kasemi	18	1+1	5348220	55	962	Valentina	Abaz	Tafa	13	1+1	5348220
2	824	Altin	Novrus	Liço	18	1+1	5348220	56	62	Ledja	Ilir	Sulaj	13	1+1	5348220
3	470	Elton	Selim	Lumani	18	1+1	5348220	57	388	Anxhela	Qamil	Hoxha	13	1+1	5348220
4	911	Gentian	Nexhip	Caca	18	1+1	5348220	58	118	Orsjola	Flamur	Memaj	13	1+1	5348220
5	954	Rozalin	Harilla	Ymeri	18	1+1	5348220	59	679	Oligerta	Jani	Ylli	13	1+1	5348220
6	799	Irena	Mdin	Andoni	18	1+1	5348220	60	822	Brixhida	Andrea	Xhuti	13	1+1	5348220
7	441	Shkelqim	Maxhun	Bardhoshi	18	2+1	7130960	61	854	Anxhelina	Kristaq	Kano	13	1+1	5348220
8	1067	Amanida	Pandeli	Gjata	18	2+1	7130960	62	354	Xhuljana	Viktor	Pëto	13	1+1	5348220
9	453	Florand	Nezir	Neziri	18	2+1	7130960	63	112	Eriona	Astrit	Gjonaj	13	1+1	5348220
10	120	Arijana	Sami	Pitarka	18	2+1	7130960	64	586	Blerina	Sofokli	Muçollari	13	1+1	5348220
11	780	Astrit	Haili	Abazi	18	1+1	5348220	65	574	Alketa	Bashkim	Arap	13	1+1	5348220
12	306	Brunilda	Nosi	Peqini	18	2+1	7130960	66	595	Orkela	Fejzi	Braho	13	1+1	5348220
13	602	Arjan	Neshet	Pajo	18	1+1	5348220	67	224	Zana	Azem	Vata	13	1+1	5348220
14	989	Halit	Demir	Dusha	18	1+1	5348220	68	452	Anila	Kujtim	Rama	13	1+1	5348220
15	1073	Mimoza	Rifat	Çoku	18	1+1	5348220	69	891	Adelina	Kadri	Tema	13	1+1	5348220
16	728	Ylber	Nezir	Shahini	18	2+1	7130960	70	1065	Jonuz	Rahmi	Kasi	13	1+1	5348220
17	657	Arben	Gani	Koçiu	18	1+1	5348220	71	998	Dashnor	Banush	Matuka	13	2+1	7130960
18	313	Markelian	Ymerli	Hoxha	18	1+1	5348220	72	282	Mariglen	Muhamet	Mema	13	1+1	5348220
19	415	Shkelqim	Sherif	Tila	18	1+1	5348220	73	908	Olsi	Rexhep	Alla	13	1+1	5348220
20	752	Ilir	Gani	Xheka	18	1+1	5348220	74	235	Bardhyl	Jonuz	Misku	13	2+1	7130960
21	997	Romeo	Lefter	Çiçolli	18	2+1	7130960	75	369	Elton	Gjergji	Goga	13	2+1	7130960
22	662	Fatbardha	Bajram	Osmani	18	2+1	7130960	76	779	Ervin	Beqir	Ndrukaj	13	2+1	7130960
23	1074	Petrit	Shkurt	Çullhaj	18	1+1	5348220	77	88	Llambi	Kristaq	Simsija	13	2+1	7130960
24	189	Rexhep	Myslim	Muja	18	2+1	7130960	78	563	Majlinda	Thoma	Dafa	13	1+1	5348220
25	893	Lorin	Lulëzim	Joniku	18	1+1	5348220	79	1020	Venetik	Vasil	Zoto	13	2+1	7130960
26	970	Andi	Lavdimir	Bejo	18	2+1	7130960	80	392	Marenglen	Riza	Bala	13	2+1	7130960
27	589	Orald	Skënder	Karapici	18	2+1	7130960	81	201	Andon	Jani	Qemali	13	1+1	5348220
28	814	Redona	Dashnor	Shehaj	18	2+1	7130960	82	915	Eduart	Besim	Dibra	13	1+1	5348220
29	144	Denajda	Fatlli	Xhaferaj	18	2+1	7130960	83	440	Elmond	Mustafa	Salliu	13	2+1	7130960
30	1044	Arijana	Besim	Çoço	17	1+1	5348220	84	276	Rigetla	Vilson	Koçi	13	2+1	7130960
31	522	Edvina	Lutfi	Kalleshi	17	1+1	5348220	85	882	Bujar	Murat	Spahiu	13	1+1	5348220
32	242	Artur	Xhezo	Dollani	17	1+1	5348220	86	660	Altin	Dilaver	Zharri	13	2+1	7130960
33	77	Arben	Foti	Konomi	17	2+1	7130960	87	200	Manjola	Gëzim	Qazimi	13	2+1	7130960
34	663	Arben	Fadil	Demrozi	17	1+1	5348220	88	579	Eva	Qemo	Çelaj	13	1+1	5348220
35	774	Martin	Pëllump	Jano	17	2+1	7130960	89	71	Adela	Preng	Zhivanaj	13	2+1	7130960
36	704	Donika	Vasil	Nikollofski	13	Gasionere	4456850	90	137	Aldo	Pashk	Shkurti	13	2+1	7130960
37	509	Ylika	Hasan	Demollari	13	Gasionere	4456850	91	156	Ardian	Fatmir	Kurti	13	2+1	7130960
38	670	Fidane	Faslli	Zhuri	13	Gasionere	4456850	92	661	Artur	Sami	Xhixha	13	2+1	7130960
39	1056	Dorina	Bashkim	Binaj	13	Gasionere	4456850	93	461	Artan	Tafil	Velaj	13	2+1	7130960
40	736	Florinda	Islam	Dreni	13	Gasionere	4456850	94	619	Johan	Pavlo	Katro	13	2+1	7130960
41	469	Erta	Stavi	Nakuçi	13	Gasionere	4456850	95	52	Alma	Vasil	Kurti	13	2+1	7130960
42	1055	Nevila	Fredi	Bullari	13	Gasionere	4456850	96	46	Rolandi	Seit	Malaj	13	2+1	7130960
43	1047	Mirjeta	Gjin	Mema	13	Gasionere	4456850	97	316	Niko	Qerim	Nuka	13	2+1	7130960
44	1048	Eriola	Agim	Canga	13	Gasionere	4456850	98	376	Aleksander	Musa	Xhafa	13	1+1	5348220
45	104	Nensi	Artan	Hoxha	13	Gasionere	4456850	99	111	Albana	Shaban	Morina	13	2+1	7130960
46	858	Kamela	Kristofor	Papa	13	Gasionere	4456850	100	427	Luljeta	Tosun	Caka	13	2+1	7130960
47	583	Maljueda	Rexhep	Lieshi	13	Gasionere	4456850	101	454	Selam	Shyqo	Rukia	13	2+1	7130960
48	889	Fatmira	Ramazan	Zeqiri	13	Gasionere	4456850	102	1068	Gëzim	Sami	Tafa	13	2+1	7130960
49	956	Emmelinda	Kujtim	Milingu	13	Gasionere	4456850	103	994	Valbona	Reis	Hasa	13	2+1	7130960
50	273	Ada	Shaqir	Qarri	13	1+1	5348220	104	592	Aleks	Sadik	Hoxhaj	13	2+1	7130960
51	866	Fatjola	Agrom	Zelia	13	1+1	5348220	105	377	Lindita	Hysen	Ogjeni	13	2+1	7130960
52	233	Griselda	Selim	Begaj	13	1+1	5348220	106	564	Gjon	Mark	Preçi	13	1+1	5348220
53	443	Bora	Fatmir	Lako	13	1+1	5348220	107	652	Sabahet	Shemsi	Saillari	13	1+1	5348220
54	37	Valbona	Nuri	Hoxhaj	13	1+1	5348220	108	880	Jurget	Luan	Shazivari	13	1+1	5348220
55	962	Valentina	Abaz	Tafa	13	1+1	5348220	109	742	Rezart	Pilo	Marko	13	1+1	5348220
								110	58	Hario	Astrit	Reçka	13	2+1	7130960

## 10 - SOCIALE

E premte 21 Dhjetor 2018

## GAZETA SHQIPTARE

111	84	Franc	Albert	Zhurda	13	2+1	7130960
112	340	Rijana	Veli	Keçi	13	2+1	7130960
113	1035	Shkelqim	Avni	Çollaku	12	2+1	7130960
114	549	Enjon	Agim	Kënga	12	1+1	5348220
115	79	Elida	Muhamet	Malogali	12	2+1	7130960
116	321	Zhaneta	Hamza	Shutina	12	2+1	7130960
117	429	Eiton	Zeni	Jaupi	11	2+1	7130960
118	197	Glesilda	Gjergji	Limka	8	1+1	5348220
119	442	Migena	Qamil	Avdia	8	1+1	5348220
120	223	Ergys	Vasil	Dako	8	1+1	5348220
121	131	Rudina	Ibrahim	Sejdi	8	1+1	5348220
122	540	Teuta	Isa	Guri	8	1+1	5348220
123	587	Ariola	Xhevit	Nurja	8	1+1	5348220
124	913	Manjola	Spiro	Kristo	8	1+1	5348220
125	640	Bardha	Shefjet	Mara	8	1+1	5348220
126	823	Anisa	Ferit	Caka	8	1+1	5348220
127	542	Elina	Sabri	Mukaj	8	1+1	5348220
128	487	Juliana	Merqez	Gaxha	8	1+1	5348220
129	859	Alba	Arben	Zhoi	8	1+1	5348220
130	445	Nentorjada	Ferdi	Kasëmi	8	1+1	5348220
131	699	Oliana	Rajmondi	Gjergjeff	8	1+1	5348220
132	902	Adelina	Razmi	Qasolli	8	1+1	5348220
133	94	Joana	Mehmet	Çelaj	8	1+1	5348220
134	457	Eica	Rexhep	Kurti	8	1+1	5348220
135	95	Armela	Ylli	Mitku	8	1+1	5348220
136	183	Beneta	Besim	Gjeta	8	1+1	5348220
137	607	Ornela	Ismet	Ruçi	8	1+1	5348220
138	673	Eliverta	Luan	Ferati	8	1+1	5348220
139	366	Anisa	Leonard	Bika	8	1+1	5348220
140	86	Entela	Ajet	Zhula	8	1+1	5348220
141	254	Edvin	Besnik	Zhupa	8	1+1	5348220
142	672	Sonila	Petrit	Hoxha	8	1+1	5348220
143	5	Elona	Sotir	Papa	8	1+1	5348220
144	535	Alba	Albert	Gjoshi	8	1+1	5348220
145	206	Enkeleida	Shyqyri	Pepa	8	1+1	5348220
146	40	Sani	Nezir	Islamaj	8	1+1	5348220
147	410	Blerina	Dashamir	Zaimi	8	1+1	5348220
148	1003	Anila	Gafur	Gishti	8	1+1	5348220
149	261	Elsa	Estref	Ibrushi	8	1+1	5348220
150	610	Marsela	Vasil	Biçiku	8	1+1	5348220
151	792	Klodiana	Pali	Deçe	8	1+1	5348220
152	930	Fatjona	Anjanit	Muho	8	1+1	5348220
153	257	Eglantina	Enver	Zaimaj	8	1+1	5348220
154	435	Illiriana	Shqipjon	Topulli	8	1+1	5348220
155	727	Elida	Jorgo	Gaqi	8	1+1	5348220
156	575	Edasarella	Bashkim	Mustafaraj	8	1+1	5348220
157	897	Artemis	Gerald	Kito	8	1+1	5348220
158	26	Alba	Franklin	Malo	8	1+1	5348220
159	81	Nevin	Latif	Bilali	8	1+1	5348220
160	338	Blerina	Lukan	Toslluku	8	1+1	5348220
161	918	Marinela	Ardian	Gjoka	8	1+1	5348220
162	332	Sonila	Robert	Jashari	8	1+1	5348220
163	765	Albana	Ismail	Velianj	8	1+1	5348220
164	861	Jonida	Islam	Tusha	8	1+1	5348220
165	894	Valmira	Fatmir	Arapi	8	Gasionere	4456850
166	569	Eralda	Shkelqim	Lamçe	8	Gasionere	4456850
167	1077	Briken	Lulzim	Alushi	8	1+1	5348220
168	658	Edon	Nikolla	Simaku	8	2+1	7130960
169	606	Eduart	Musa	Pulake	8	Gasionere	4456850
170	383	Endrit	Sezai	Kofina	8	2+1	7130960
171	1080	Dorjan	Vangjel	Kushi	8	2+1	7130960
172	713	Arben	Mahmut	Meçi	8	2+1	7130960
173	851	Gentian	Ali	Balliu	8	2+1	7130960
174	653	Eduart	Xhezmi	Blaçëri	8	2+1	7130960
175	255	Leonard	Agim	Lile	8	2+1	7130960
176	433	Florian	Mihal	Koraçe	8	2+1	7130960
177	807	Edison	Fatmir	Kollarja	8	2+1	7130960
178	864	Jolka	Aleksandër	Papuçiu	8	1+1	5348220
179	910	Leonard	Kosta	Haxhiu	8	1+1	5348220
180	565	Brixhilda	Ymer	Daja	8	1+1	5348220
181	15	Florian	Llukman	Hoxha	8	1+1	5348220
182	519	Eraldo	Vasil	Stopani	8	2+1	7130960
183	988	Raimonda	Vezir	Toska	8	2+1	7130960
184	20	Dritan	Luan	Bahani	8	2+1	7130960
185	236	Altin	Sefedin	Shehu	8	2+1	7130960
186	194	Adrian	Viron	Bizhga	8	1+1	5348220
187	1070	Besnik	Sadri	Elezaj	8	2+1	7130960
188	518	Igli	Çuman	Muçaj	8	2+1	7130960
189	78	Kreshnik	Muhamet	Çobo	8	2+1	7130960
190	57	Ergys	Fatmir	Likaj	8	2+1	7130960
191	953	Edmond	Sadik	Muja	8	2+1	7130960
192	122	Luan	Haxhi	Haxhi	8	2+1	7130960
193	192	Naum	Vasil	Nikolla	8	2+1	7130960

194	647	Gjergji	Thanas	Zoto	8	2+1	7130960
195	243	Armando	Refat	Kosova	8	2+1	7130960
196	155	Altin	Agim	Koçi	8	2+1	7130960
197	826	Artur	Xhezmi	Duro	8	1+1	5348220
198	577	Sulejman	Avdulla	Tanushi	8	2+1	7130960
199	456	Enrieta	Isuf	Nurellari	8	2+1	7130960
200	96	Gëzim	Mehmet	Mefaja	8	2+1	7130960
201	53	Destemon	Mane	Pazaj	8	2+1	7130960
202	502	Gjergj	Kol	Bushi	8	1+1	5348220
203	108	Mexhit	Qeram	Izetaj	8	1+1	5348220
204	262	Besnik	Mynyr	Arapi	8	1+1	5348220
205	408	Ina	Arben	Jakupaj	8	Gasionere	4456850
206	678	Anisa	Naim	Skënderi	8	1+1	5348220
207	804	Vitrona	Vlash	Derishaj	8	1+1	5348220
208	145	Armando	Vangjel	Naska	8	1+1	5348220
209	400	Sara	Halil	Kosova	8	1+1	5348220
210	263	Endrit	Ylli	Bami	8	1+1	5348220
211	135	Albina	Zef	Vocaj	8	1+1	5348220
212	344	Emiljano	Neim	Lame	8	2+1	7130960
213	203	Luljeta	Neki	Çela	8	2+1	7130960
214	504	Klajdi	Ndriçim	Duka	8	2+1	7130960
215	83	Marvin	Agim	Zyberli	8	2+1	7130960
216	538	Brikena	Përparim	Muçaj	8	2+1	7130960
217	178	Besmir	Fatmir	Agalliu	8	2+1	7130960
218	690	Artur	Sami	Guzina	7	2+1	7130960
219	666	Artan	Bashkim	Duva	7	2+1	7130960
220	45	Aurora	Agron	Isallari	3	1+1	5348220
221	904	Ramadan	Selam	Ajasllari	3	1+1	5348220
222	856	Hair	Beqir	Beqo	3	2+1	7130960
223	626	Sevasti	Llazar	Diamanti	3	2+1	7130960
224	981	Ermelinda	Albert	velo	3	1+1	5348220
225	278	Aurora	Rafail	Bushi	3	1+1	5348220
226	632	Eduard	Mirash	Mrishaj	3	1+1	5348220
227	325	Nertila	Ridvan	Mulla	3	1+1	5348220
228	482	Antiola	Andon	Zotaj	3	1+1	5348220
229	288	Joana	Afrim	Mullara	3	2+1	7130960
230	119	Jurgen	Petrit	Muka	3	2+1	7130960
231	198	Kledion	Nevruz	Çullaj	3	1+1	5348220
232	262	Benard	Ali	Meneri	3	2+1	7130960
233	737	Viljand	Valjer	Peshkëpia	3	1+1	5348220
234	879	Esmeralda	Xhevair	Starova	3	2+1	7130960
235	1075	Leonard	Zeqir	Lalaj	3	2+1	7130960
236	162	Junilda	Meçan	Tice	3	2+1	7130960
237	729	Eljona	Lavdosh	Pulaj	3	1+1	5348220
238	417	Violeta	Salih	Paçuku	3	1+1	5348220
239	721	Albana	Enver	Kongjoni	3	2+1	7130960
240	1034	Shpresa	Fejzi	Dymishi	3	1+1	5348220
241	811	Edmond	Abdulla	Çoku	3	1+1	5348220
242	1036	Pranvera	Ali	Golemi	3	1+1	5348220
243	547	Faik	Ali	Bitri	3	1+1	5348220
244	578	Xhevahir	Selim	Sinani	3	2+1	7130960
245	447	Klodiana	Haki	Danaj	3	Gasionere	4456850
246	110	Senada	Spartii	Jaho	3	Gasionere	4456850
247	375	Erlenda	Gaqi	Xharo	3	Gasionere	4456850
248	380	Miranda	Mehmet	Goçi	3	Gasionere	4456850
249	941	Enkelana	Bashkim	Shala	3	Gasionere	4456850
250	76	Marsela	Vladimir	Çibukaj	3	Gasionere	4456850
251	68	Zëgjine	Faredin	Kurti	3	Gasionere	4456850
252	147	Alma	Përparim	Tola	3	Gasionere	4456850
253	932	Erlin	Qatip	Myrtaj	3	Gasionere	4456850
254	270	Margjlen	Agron	Mushgjata	3	Gasionere	4456850
255	900	Granit	Dalip	Sulko	3	Gasionere	4456850
256	1008	Petrit	Shpëtim	Berati	3	Gasionere	4456850
257	785	Florida	Avni	Vasjari	3	Gasionere	4456850
258	938	Xheni	Bashkim	Tresa	3	Gasionere	4456850
259	180	Bledjan	Haxhi	Neli	3	Gasionere	4456850
260	121	Elsava	Sali	Dedja	3	Gasionere	4456850
261	177	Ana	Zija	Shkreta	3	Gasionere	4456850
262	341	Sokol	Myslym	Qaja	3	Gasionere	4456850
263	505	Amariida	Arshin	Braho	3	Gasionere	4456850
264	686	Iva	Esat	Balla	3	Gasionere	4456850
265	54	Dorina	Bujar	Begolli	3	Gasionere	4456850
266	132	Ornel	piro	Tola	3	Gasionere	4456850
267	636	Brikena	Gjon	Çoku	3	Gasionere	4456850
268	152	Edlira	Xhemal	Midha	3	Gasionere	4456850
269	510	Enjon	Rahim	Alliu	3	Gasionere	4456850
270	876	Eralda	Perparim	Hoxha	3	Gasionere	4456850
271	920	Eriona	Agim	Goxha	3	Gasionere	4456850
272	926	Enkeleida	Zenjel	Fejzo	3	Gasionere	4456850
273	944	Desara	Vladimir	Qose	3	Gasionere	4456850
274	557	Ardit	Sazan	Miraçi	3	Gasionere	4456850
275	980	Anila	Bexhet	Dukaj	3	Gasionere	4456850
276	939	Todi	Noikollaç	Karoli	3	Gasionere	4456850











# MAK ALBANIA HOTEL

31 Dhjetor 2018

20:30



PJESË E  
KASTRIOTI GROUP



MAK ALBANIA HOTEL

## Nata e ndërrimit të viteve!

- ~ Menu me 7 raunde dhe pije të përfshira
- ~ Muzikë dhe Argëtim Live nga këngëtarët Altin Goci, Marsela Çibukaj, grupi Ali Pashe Tepelena dhe cirku i Tiranës
- ~ Gëzuar Vitin e Ri me "Moët Chandon" dhe fishekzjarre në tarracën e Infinity Bar
- ~ Shorte me dhurata



**Për prenotime deri me datë 20 Dhjetor, për cdo 6 persona i 7-i falas  
Ofertë speciale akomodimi për muajin Dhjetor 75 euro çifti**

### Terma dhe kushte

Menu speciale për fëmijë me 50% zbritje për moshën 5-12 vjeç  
Fëmijët 0-5 vjeç falas  
Parkim i garantuar pa pagesë



+355 4 2274 707



+355 69 20 25205



sales.tirana@makalbania.com



Drejtori i klubit të prodhuesve: Duhet të ketë korrigjim të ekonomisë

# Taksa 100%, Kosova importon lëndë të parë nga Serbia

Pas 4 javësh janë zhdoganuar vetëm 174 kamionë

Pas katër javësh nga vendimi i Qeverisë së Kosovës për tak- sën doganore 100 për qind për produktet me origjinë nga Serbia dhe Bosnja Hercegovina, janë dësh- muar rënie të larta të im- portit të këtyre mallrave në tregun e Kosovës. Sipas të dhënave të Doganës se Kosovës, nga data 21 nën- tor kur ka filluar të zba- tohet vendimi i Qeverisë se Kosovës, nga këto sh- tete janë zhdoganuar 174 kamionë (145 nga Serbia dhe 29 nga Bosnja), krye- sisht lëndë e parë për prodhuesit kosovarë, të cilët kanë paguar taksën mbrojtëse mbi 290 mijë euro (250 mijë nga Serbia dhe 41 mijë euro nga Bos- nja Hercegovina). Kurse në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, nga Serbia dhe Bosnja në Kosovë kishin hyrë nga 2800 deri në 3000 maune me produkte të ndryshme, me një vlerë prej 35 milionë eurosh. Këtu janë përf- shirë edhe maunet me produkte nga këto dy sh- tete, por edhe ato ndërko- mbëtare të prodhuara në Serbi dhe Bosnje, ka treguar për Radion Evro- pa e Lirë, Adriatik Stavileci, zëdhënës i Doganës së Kosovës. Përfaqësues të komunitetit të prodhuesve në Kosovë janë shprehur se tarifa doganore ndaj prodleve të Serbisë dhe Bosnjës i ka dhënë efektet e veta në ekonominë e përgjiths- hme të Kosovës. Sipas tyre, një nga efektet është rritja e prodhimit vendor. Drejtori ekzekutiv i Klubi- t të Prodhuësve të Kos- ovës, Astrit Panxha, thotë për Radion Evropa e Lirë se pas vendosjes së taksës, kompanitë prodhuese vendore kanë pohuar se kanë rritje të kërkesës për produktet e tyre dhe njëherësh tashmë kanë rritur edhe numrin e punë- torëve. Ai thotë se Qeveri- a e Kosovës nuk duhet të



Adriatik Stavileci

zbrapsset nga vendimi për tarifën, për shkak se këto shtete nuk kanë pa- sur qasje të duhur ndaj prodhuesve të Kosovës. "Ne kemi kërkuar reci- procitet për shkak të qasjes së Serbisë ndaj prodhuesve të Kosovës. Për ne është me rëndësi që të ketë korrigjim të ekono- misë brenda territorit të Kosovës. E kemi thënë edhe në të kaluarën se një prej problemeve ka qenë Serbia. Por, kemi problem edhe të importuesve të mëdhenj në Kosovë, të cilët vazhdojnë të favori- zojnë produktet e importit dhe jo produktet vendëse. Pa ndryshuar qasja e Ser- bisë ndaj sektorit të ekono- misë së Kosovës, sidomos prodhimit, nuk i rekoman-

doj Qeverisë se Kosovës që të heqë këtë taksë", tha Panxha. Qeveria e Kosovës deri më tani nuk është zbrapsur nga vendimi për tarifën 100 për qind, e cila vazhdon të mbetet në fuqi, pavarësisht faktit se ky vendim ka nxitur reagime të ashpra të serbëve në Kosovë dhe të autoriteteve në Beograd dhe Sarajevë. Por, edhe mekanizmat ndërkombëtarë si Komisioni Evropian dhe Shte- tet e Bashkuara të Amerikës kanë kërkuar që të hiqet taksja, duke e konsideruar atë si shkel- je të Marrëveshjes për Tregti të Lirë, të njohur si CEFTA. Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ndërkaq ka përsëritur qëndrimin se tarifa ndaj



mallrave të Serbisë dhe Bosnje Hercegovinës nuk do të hiqet deri në njohjen e pavarësisë së Kosovës. Ai ka thënë se ky qëndrim do të mbetet i pandryshuar, pavarësisht se kush është kryeministër apo ministër i Tregtisë. Kurse Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka thënë

se bisedimet për normali- zimin e marrëdhënieve në mes Prishtinës dhe Beog- radit do të vazhdojnë vetëm kur të tërhiqet tari- fa. Ai këtu komente i ka bërë gjatë takimit në Bruk- sel të udhëheqësve të vendeve të Ballkanit Perëndimor me zyrtarë të BE-së, që është mbajtur

**ASTRIT PANXHA**

"Ne kemi kërkuar reciprocitet për shkak të qasjes së Serbisë ndaj prodhuesve të Kosovës. Për ne është me rëndësi që të ketë korrigjim të ekonomisë brenda territorit të Kosovës. E kemi thënë edhe në të kaluarën se një prej problemeve ka qenë Serbia, gjithashtu problem janë edhe importuesit e mëdhenj në Kosovë, të cilët vazhdojnë të favorizojnë produktet e importit dhe jo produktet vendore", tha Panxha.

me ftesë të shefes për Poli- tikë të Jashtme dhe Siguri e Bashkimit Evropian, Fe- derica Mogherini.

## Macron rrit pagat e policëve, pasi e kërcënuan me protesta

Qeveria franceze është përkulur para kërcënimeve për protesta të policisë ven- dase, duke përmbytur disa nga kërkesat e tyre më urgjente. Vendimi i njoftua të enjten (20 dhjetor) nga Ministria e Brendshme franceze pas takimeve me tri sindika- ta lokale të policisë. Palët ranë dakord për rritjen graduale të pagës së policëve nga 120 deri në 150 euro në muaj për funksionarët e rangut të lartë dhe shlyerjen e page- save të vjetra për rreth 23 milionë orë punë jashtë orari të akumuluarra përgjatë viteve, veçanërisht në protestat e muajit të fundit. Sipas qeverisë, përmbyshja e këtyre detyrimeve do të nisë vitin tjetër dhe pritet që t'i kushtojë buxhetit të shtetit rreth 275 milionë euro. Sindikatat e mirëpritën vendimin, duke e cilësuar akordin një progres real pas ankesave prej vitesh. Marrëveshja erdhi pas protestave të shpërnda- ra që oficerët e policisë mbajtën anembanë vendit një ditë më parë. Të mërkurën, policët francezë improvizuan një demonstratë duke ecur me hap të ngadaltë në ter- minalin e aeroportit "Sharl de Gol" në Paris, çka krijoi radhë të gjata për pasagjerët që pritin të merrnin linjën e radhës.

## Mashtrori lexuesit, pushohet gazetari kryesor i "Der Spiegel"

Është pushuar nga puna pasi kishte botuar artikujt e tij, të cilat ishin vlerësuar me një sërë cmimesh prestigjioze gazetari kryesor i gazetës gjermane "Der Spie- gel", Claas Relotius. I shpallur gazetari vitit 2014 nga CNN, gazetari Relotius kishte mashtruar lexuesit dhe teleshikuesit me histori të rreme, burime të pavërteta dhe citime false. "E vërteta dhe gënjeshtra janë të ngatërruara në tekstet e tij", bëri të ditur "Der Spiegel" në një prononcim. Disa prej rreth 60 artikujve që Relotius i ka shkruar qysh në vitin 2011 janë të saktë, por të tjerët janë "krejtësisht të shpikur ose të zbuluar me citime të manipuluar ose fantazi", njoftoi gazeta. Nga arti- kujt e publikuar, njëri ka të bëjë me një të burgosur të Guantanamo, ndërsa një tjetër me fëmijët e rrëmbyer nga grupi militant ISIS. Der Spiegel nënvizoi se kjo ishte pika më e ulët në historinë 70-vjeçare të kësaj të përditshmeje. Der Spiegel tha se Relotius, 33 vjeç, e ka pranuar se i ka mashtruar lexuesit me rreth 14 artikuj. "Sa më shumë bëhëna ai suksesshëm, aq më shumë rritte presioni mbi mua për të mos gabuar", raportohet të ketë thënë gazetari gjerman.

## Ngjarja e 27 prillit, politikanit Arnaudov i japin 160 euro për ligjin e amnistisë

Gazetarët kanë mbledhur një shumë parash për deklaratat e deputetit të akuzuar Arnaudov, i cili para gjykimit për ngjar- jet e 27 prillit kishte kërkuar nga 50 euro për deklaratat për ligjin e amnistisë. Gazetarët gjatë pushimit së gjykimi për organizimin e sulmit të 27 prillit vitin e kaluar, mblodhën 160 euro për të paguar depu- tetin e akuzuar nga radhët e VMRO DPMNE- së Luben Arnaudovski, i cili u kishte kërkuar nga 50 euro për dek-

laratë. "Urdhëroni zotëri Arnaudov, mblodhëm paratë për deklaraten tuaj, do të na thoni tani a do të dorëzoni kërkesë për amnistinë?", e pyetën gazetarët pas pauzës. "Jo, jo, unë tallesha", tha ai. "Por, ju na nënçmuat", i thanë gazetarët. "Unë po qesh, desha t'ju bëj edhe juve të qeshni, nuk kisha qëllim t'ju ofendoj", tha Arnaudov. Ky është gjykimi i parë për ngjarjet e 27 prillit, pasi deputetët dy ditë më parë votuan një ligj të posaçëm për amnis- ti, në lidhje me sulmet në Kuvend.

**DEPUTETI ARNAUDOV**  
"Urdhëroni zotëri Arnaudov, mblodhëm paratë për deklaraten tuaj, do të na thoni tani a do të dorëzoni kërkesë për amnistinë?", e pyetën gazetarët pas pauzës. "Jo, jo unë tallesha", tha ai. "Por, ju na nënçmuat", i thanë gazetarët. "Unë po qesh, desha t'ju bëj edhe juve të qeshni, nuk kisha qëllim t'ju ofendoja", tha Arnaudov.



Rrëfëhet zogu i Tironës: Jam i lumtur me ato që kam arritur në televizion

# HERMES NIKAJ:

## Kam lindur në luks, shpenzoj shumë, nuk di ta ruaj paranë

*"Eleganca për mua është sjellje, stil dhe qëndrim"*

Egla Xhemali

**A**i është një nga personazhet më të dashur për publikun shqiptar. E kemi njohur për Hermes Nikaj që për shumëkënd njihet me nofkën "Zogu i Tironës". Pas një mbyllje të suksesshme në "Aldo Morning Show", ai vjen çdo ditë në emisionin "Dita e re" në "Ora news", ku interviston të famshmit. Ka vetëm tre muaj që Hermes ka festuar 25-vjetorin në një festë gjigante. Gjithçka është perfekte për sa kohë ai dhuron vetëm energji pozitive. Për "Gazeta Shqiptare" Nikaj tregon detaje nga ditët e tij, se kur e quan një femër pa shije, deri ku e lejon të dashurën që të ndërhyjë, raportin që ka me paranë, festën madhështore që organizoi për ditën e lindjes, si dhe atmosferën e dhjetorit në shtëpinë e tij. Ai është i lidhur fort me punën, që është njëkohësisht edhe pasion i tij. Hermes pohon se është rritur në luks dhe raportin me paranë nuk e ka dhe aq të mirë pasi shpenzon shumë. Festa e ditëlindjes që u mbajt larg syve të medias që një organizim i jashtëzakonshëm. Duket se televizioni do jetë edhe më tej shtëpia e tij e madhe. Për të gjitha i falet Zotit. Sukseset arrihen vetëm me besim dhe duke punuar!

### Si është një ditë për ty?

Një ditë me mua është plot energji dhe plot me punë të planifikuara me parë. Zgjedhëm rreth orës 6:00 të mëngjesit, ndërkohë që pi kafën dhe lëngun e portokallit, pastaj vishem dhe dal nga shtëpia. Rreth orës 7 e 45 më duhet të jem gati pasi filloj transmetimin në "Ditë e re". Pjesën më të madhe të ditës e kaloj me regjistrime dhe duke planifikuar temat apo personazhet e programit. Megjithatë jam i zënë, gjej kohën për të takuar miqtë herë për herë ose për darkë. Më pas koha dedikuar familjes.

### Karriera po shkon mirë, po jeta private si shkon?

Jeta private shkon shumë mirë. Kur një femër për ty është pa shije?

Kur është fodulle, e paedukatë dhe jo e veshur mirë.

### Deri ku e lejon partneren tënde të ndërhyjë?

Çdo gjë e ka një limit, gjella me kripë dhe kripa me karar thotë



populli.

### Kemi parë që bën një jetë tejet luksoze, cili është raporti yt me paranë?

Unë kam lindur dhe jam rritur në luks. Luksi është pjesë e imja. Shpenzoj shumë, nuk di ta ruaj paranë. Faleminderit të madhit Zot për gjithçka!

### Para tre muajsh festova 25-vjetorin, çfarë synon më tej në punën tënde në televizion në këto vite maturimi që të presin?

Po, festova 25-vjetorin në një festë plot zhurmë, por private dhe jashtë kamerave. Jam i lumtur dhe i kënaqur me çfarë kam arritur në televizion. Sigurisht që synoj më të mirën dhe mendoj se ia kam dalë mbanë deri tani.

Si festohen festat në shtëpinë



### e Hermesit?

Me drita, me ngjyra, me këngë Krishtlindjesh, me panetone e bakllava, me dëshirë për të dhuruar etj..

### Ku e gjen frymëzimin në jetë dhe çfarë ju apasionon?

Te njeriu që dua. Është forca ime. Te gjërat e bukura... Shmang energjitë e këqija dhe konfliktet që lindin nga mendjet e cekëta.

### Cilat janë idealet e tua?

Dashuria për familjen. Ai është

“

Ai është i lidhur fort me punën, që është njëkohësisht edhe pasion i tij. Hermes pohon se është rritur në luks dhe raportin me paranë nuk e ka dhe aq të mirë pasi shpenzon shumë.

habitati më i mirë për një shpirt të lumtur. Është dashuri e pakushtëzuar.

### Ç'është elegancë për ty?

Eleganca për mua është sjellje, është stil dhe qëndrim.

### Përveç gazetarisë, profesioni me të cilin ke menduar të sigurosh jetën?

Jam shumë i lumtur për çdo mundësi që më është dhënë në jetë. Mendoj se në çfarëdo profesioni të isha, do të bëja më të mirën time që të arrija sa më lart. Televizioni besoj se do të jetë një pjesë e imja për një kohë të gjatë në të ardhmen.

REPORTAZH

Të dhënat zyrtare të siguruar nga BIRN dhe intervistat me mjekë dhe drejtues spitalësh tregojnë se maternitetet shqiptare kanë një mungesë të theksuar inkubatorësh dhe pajisjesh mjekësore të nevojshme për të trajtuar foshnjat e lindura para kohe, një situatë e rënduar prej vitesh, që po rrit në mënyrë alarmante vdekshmërinë foshnjore.

# Bebet vdesin në maternitetet për mungesë inkubatorësh

Ardash Bushi  
Enrik Mehmeti

**STATISTIKAT**

Sipas të dhënave të raportuara nga INSTAT dhe dy qendrat universitare spitalore obstetrikogjinekologjike 'Koço Gëlozheni' dhe 'Mbretëresha Geraldinë', më shumë se një e treta e lindjeve në vend ndodh në këto dy maternitete.

Në një mbledhje rutinë mëngjesin e 11 janarit 2018 në Spitalin Universitar Obstetrik-Gjinekologjik 'Koço Gëlozheni' në Tiranë, diskutimet u ndërprejnë kur fjalën e mori një mjekë nga shërbimi i Neonatologjisë, e cila iu drejtua e shqetësuar ish drejtorit Arben Rugia.

"Nuk mund të bëjmë sikur nuk ka ndodhur asgjë, po na vdes çdo ditë nga një fëmijë," tha mjekja neonate, duke shtangur kolegët e saj. "Është e pamundur të punojmë në këtë situatë," shtoi ajo, përpara se të ndërprej nga Rugia, i cili e këshilloi që kjo bisedë nuk mund të bëhej në mbledhje.

Të dhënat e siguruar nga BIRN tregojnë se nga dita e Krizës lindjeve 2017 deri më 15 janar 2018, 11 foshnja të lindura 'prematurre' humbën jetën në këtë spital universitar. Në përgjigjen zyrtare, materniteti "Koço Gëlozheni" pranoi se gjysma e këtyre vdekjeve mund të ishin parandaluar, nëse spitalit nuk do t'i mungonin aparatat e nevojshme mjekësore.

"Në më shumë se 50% të rasteve [që ndërruan jetën në fillim të janarit] bëhet fjalë për shtatzani shumë të vogla, për të cilat ne nuk kemi teknologji të përshtatshme për të siguruar mbijetesën," tha spitali në një përgjigje me shkrim.

Në këtë maternitet ka një mungesë të theksuar inkubatorësh dhe shumica e inkubatorëve ekzistues janë jashtë funksionit. Pjesa e mbetur mund të përballojë vetëm gjysmën e pacientëve të vegjël që kanë nevojë për terapi intensive - një situatë e cila vazhdon prej vitesh, ndërkohë që Drejtoria e Spitalit dhe Ministria e Shëndetësisë kanë bërë një vesh shurdh dhe një sy qorr ndaj kërkesave të vazhdueshme të mjekëve.

"Ka të paktën 15 vite që në këtë shërbim nuk është bërë asgjë, vetëm ca prekje të vogla. Ministria i di të gjitha dhe jo vetëm kjo ministri, por të gjithë... pasi që është një problem që vazhdon prej vitesh," tha Edi Tushe, shefi i shërbimit të Neonatologjisë në "Koço Gëlozheni".

"Edhe ato aparatat që kemi janë shumë të vjetruara në teknologji. Duhet të kesh mik ndonjë ministër apo dikë tjetër të rëndësishëm në qeveri që t'i lutesh e të sjellin ndonjë gjë për spitalin," shtoi ai, duke nënvizuar se stafi i mjekëve dhe i infermierëve po i rrudhet çdo ditë nga dorëheqjet për shkak të kushteve të papranueshme të punës.

"Koço Gëlozheni" nuk është i vetmi maternitet në Shqipëri që ka mungesë inkubatorësh, mjekësh dhe pajisjesh të tjera mjekësore, jetike për mbijetesën e foshnjave të lindura me probleme. Të dhënat e siguruar nga BIRN dhe intervistat me mjekë dhe drejtues në spitalet rajonale, tregojnë që e njëjta situatë alarmante është e përhapur në të gjithë Shqipërinë, e cila në vitin 2016 regjistroi për herë të parë në dy dekada, rritjen e vdekjeve tek fëmijët nën moshën 1 vjeç.

Vdekje të paralajmëruara Shifrat e vdekshmërisë foshnjore në Shqipëri janë ndër më të lartat në rajonin e Ballkanit. Sipas të dhënave të Agjencisë së Vlerësimit të Vdekshmërisë Foshnjore të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, në Shqipëri ka pasur 6.2 vdekje për 1000 fëmijë të lindur në vitin 2017 - vendi i dytë pas Maqedonisë për vdekshmërinë foshnjore në rajon.

Sipas Institutit Kombëtar të Statistikave, INSTAT, vdekjet e fëmijëve nën 1 vjeç në Shqipëri u rritën me mbi 19 për qind gjatë vitit 2016, duke shënuar edhe rritjen e parë në dy dekada të këtij treguesi. Gjatë vitit 2016, 277 fëmijë nën 1

shkurtër e kishte tronditur stafin mjekësor të spitalit.

"Sapo dolëm nga mbledhja u interesuam se çfarë kishte ndodhur dhe morëm vesh që 24-orëshin e fundit kishin ndërruar jetë dy foshnja dhe 10 në total për 10-ditëshin e parë të janarit," tha një mjek gjinekolog me 15 vjetë eksperiencë. "Ishte vërtet tronditëse," shtoi ai.

Një mjek tjetër i shërbimit të gjinekologjisë shpjegoi që në shërbimin e Neonatologjisë në atë periudhë kishte më shumë pacientë se inkubatorë, 'kështu që bëheshin edhe lidhje dyshe' të foshnjave në pajisjet mjekësore jetike për mbijetesën e tyre.

"Unë kam 10 vjet që punoj aty dhe nuk ka ndodhur kurrë një situatë e tillë, ishte vërtet absurde, edhe pse fëmijët, sipas asaj që mësuam, ishin të gjitha lindje me problem," tha ai. "Më besoni, që për një mjek është dëshpëruese të punojë në një situatë të tillë."

Në një përgjigje të detajuar për BIRN, maternitetin 'Koço Gëlozheni' u ankuu se nga 24 inkubatorë që i duhen, ka vetëm 6 në funksion. Por inkubatorët nuk janë të vetmet pajisje mjekësore që i mungojnë shërbimit të Neonatologjisë të këtij spitali. Mungesa ka në ven-

Mungesa e pajisjeve mjekësore në maternitetin "Koço Gëlozheni".

Pajisjet	Nevojat (standart)	Në funksion	Jashtë funksionit
Analizator i Oksigjenit	2	-	-
aparate oshimetric për matjen e tensionit arterial (Dinamap)	3	-	-
Aparat radiologjik*	1	1	-
aparate fototerapie (përfahi dhe për fototerapi intensive)	8	3	2
Aparatet për CPAP	20	10	7
bilirubonometër transkutan	4	-	2
Ekografe	1	1	-
Glukometer	2	-	-
Hemogazmetër	1	1	-
Hood (kaskë oksigjenimi)	10	-	-
Inkubatore transporti *	2	2	2
inkubatorë	24	6	20
laringoskopi	10	1	1
Monitore të Apnoes (FK dhe FR + sinjal Apnoe)	10	-	-
monitorë multifunksionale	10	4	16
ngrohëse radiant	6	4	4
peshore	4	1	jane te priahura
Pompa infuzive/shiringa elektrike	60	23	shumë
pulsoksimetër	20	3	2
ventilatorë	10	4	4

\* Inkubatorët të papërshtatshëm për transportin intensivë në drejtim të QSUT dhe 2 jo vetëm jashtë funksionit por mbi 20 vjeçarë \* Aparatet i radiologjisë nuk mund të shfrytëzohen 24 orë sepse mungon laboratoriu dhe QSUT përgjigjet vetëm paradite për lajen e filmave \* Aparatet e fototerapisë prodhim para 2004 dhe nuk lejohen për t'i shfrytëzuar për fototerapi intensive  
Chart: BIRN Albania - Source: SUDGJ "Koço Gëlozheni" - Created with Datawrapper



vjeç humbën jetën nga 233 vdekje të tilla që qenë shënuar në vitin 2015. Përgjatë 2017-ës janë shënuar 248 vdekje nën 1 vjeç përkundër 30,869 lindjeve të regjistruara. Pjesë e kësaj tabloje të zymt statistikore janë edhe 11 foshnjat që humbën jetën në maternitetin 'Koço Gëlozheni' në fillim të vitit 2018. Dy mjekë që ishin të pranishëm gjatë mbledhjes së 11 janarit dhe folën në kushtet e anonimit, i thanë BIRN që numri i lartë i vdekjeve për një kohë aq të

tilatorë, pulsoksimetër, pompa infuzive, laringoskopë dhe një listë të gjatë pajisjesh të tjera, të cilat janë të nevojshme për të trajtuar foshnjat e lindura me probleme. Edhe ato pak pajisje që janë funksionale, janë të gjatë dhe të amortizuara, kushte që sipas mjekëve kërcënojnë seriozisht shërbimin ndaj pacientit.

Shefi i shërbimit të Neonatologjisë, Edi Tushe tha në një intervistë për BIRN se materniteti "Koço Gëlozheni" ka një mesatare

prej 4500 lindjesh në vit, ndërkohë që mesatarisht janë rreth 700 fëmijë që shtrohen në terapi intensive dhe kanë nevojë për kujdes të specializuar.

"Në kushtet që kemi mund të përballojmë 50% të rasteve," nënvizoi Tushe.

Profesor Tushe sqaron se prej vitesh, mjekët e këtij shërbimi i kanë dërguar me dhjetëra shkresa drejtorisë së spitalit, e cila më pas ia delegon Ministrisë, ku i vë në dijeni për situatën 'skandaloze' ku duhet të punojnë, por të gjitha kërkesat e tyre kanë rënë në vesh të shurdhër. Disa prej këtyre kërkesave, të lexuara nga BIRN, paralajmërojnë drejtorinë e spitalit se kujdesi ndaj shëndetit të pacientëve nuk është më i mundur me aparatat dhe pajisjet mjekësore në dispozicion.

"Mungesa e aparatave dhe aksesoreve e bën të pamundur kujdesin që duhet ofruar për neonatë intensivë dhe subintensivë," shkruan Tushe në një shkresë drejtuar Drejtorisë së Spitalit në shtator 2017.

Një paralajmërim të ngjashëm mban dhe një kërkesë më e herët në kohë, e vitit 2016. Në janar të 2018-ës, pas vdekjes së 11 foshnjave,

materniteti i ka dërguar një relacion të zgjeruar Ministrisë së Shëndetësisë për situatën e vështirë të cilën ndodhet, por sërish nuk ka pasur asnjë reagim konkret. Sipas përgjigjes zyrtare për BIRN, aktualisht materniteti ka 20 inkubatorë jashtë funksionit dhe 6 në funksion, ndërkohë që në terapi intensive çdo ditë kanë nevojë për shërbim 18 deri në 34 bebe.

"Gjatë 2017 në repartin e kujdesit intensiv u shtruan 957 fëmijë, me një mesatare ditë-qëndrimi në inkubator nga 2 deri në 98 ditë," shkruhet në përgjigjen e maternitetit "Koço Gëlozheni".

"Ka ditë që në inkubatorë janë 8-19 fëmijë prej të lindurve në maternitet dhe 6-15 fëmijë të ardhur nga rrethet. Shtretër të zënë mesatarisht çdo ditë janë 18 dhe në ditë të caktuara mund të shkojë deri në 34," shton materniteti.

Ndërkohë, në një kërkesë urgjente që mban datën 22 nëntor 2018, drejtuar kreut të këtij spitali dhe nëndrejtorit ekonomik, shërbimi i Neonatologjisë vë në dijeni për të disatën herë drejtuesit e lartë se ka nevojë emergjente për zëvendësimin e dozimetrave të ajrit dhe oksigjenit, të cilat janë pothuajse jashtë funk- ➔



sionit.

"Ju rikujtojmë se mos-funksionimi i tyre e bën të pamundur kryerjen e reanimimit të bebeve që kanë nevojë për reanimim në sallat e lindjes dhe operacionit. Ky problem është prezent prej shumë kohësh, por janë gjetur forma alternative për të realizuar këtë funksionim provizor të tyre. Aktualisht reanimimi është i pamundur me aparatet Neo Puff," shkruan shërbimi i Neonatologjisë, i cili i kërkon drejtorisë së spitalit "të marrë masa në mënyrë emergjente për njësitë reanimatore (Neo Puff) në sallat e lindjes, të zëvendësohen rezistenca që prej kohësh nuk funksionojnë".

Kjo qendër spitalore universitare, që pret rastet më të rënda edhe nga të gjitha spitalet e rrethëve, ka vetëm një laringoskop-një instrument shumë i domosdoshëm për të hapur rrugët e ajrit dhe realizuar kështu frymëmarjen e drejtuar nga aparaturat. Materniteti përballet me vështirësi edhe kur duhet të dërgojë një të porsalindur me probleme shëndetësore drejt QSUT-së, pasi ka vetëm 2 inkubatorët për transport intensiv, të cilët janë të vjetër mbi 20 vjet dhe të papërshtatshëm.

Një infermiere e shërbimit të terapisë intensive që foli me BIRN në kushtet e anonimitatit nënvizoi që gjendja në shërbimin e Neonatologjisë ishte dëshpëruese.

"Kemi nevojë për aparatura dhe medikamente," tha ajo. "Si t'i them unë një prindi që nuk ka maskë oksigjeni për fëmijën e tij... Ne kemi vetëm duart, por këta fëmijë nuk shpëtohen vetëm me duart tona," shtoi infermierja.

Megjithatë, pavarësisht vështirësive të mëdha materniteti deklaroi se "ndodh ekstremisht rrallon" që të fusin dy fëmijë në një inkubator, por edhe në rastet kur ndodh, bëhet për të lindurit binjakë, pasi sipas tyre kjo ka vetëm efektet negative në shëndetin e foshnjës.

Kushtet e punës largojnë mjekët Sipas shefit të shërbimit të Neonatologjisë, Edi Tushe, mungesa e kushteve në punë po sjell largimin e mjekëve specialistë dhe të infermierëve. Vetëm gjatë 2018-ës kanë dhënë dorëheqjen nga posti i mjekut neonat në këtë maternitet 3 mjekë. Nga 45 infermiere që i duhen këtij reparti intensiv dhe sub-intensiv, në organikë janë vetëm 20 infermiere, ndërkohe aktualisht në punë janë 17 - pasi një pjesë e tyre marrin leje barrë lindjeje apo kanë probleme të tjera shëndetësore.

"Po më ikën edhe një mjek dhe shumë shpejt do punoj me 4 mjekë neonatë nga 8 që e kemi strukturën," tha Tushe. "Për çdo mungesë dhe problem kemi vënë në dije-ni të gjitha instancat, por situata vazhdon pa zgjidhje prej vitesh," shtoi ai.

Një nga mjekët që është larguar nga shërbimi i Neonatologjisë në "Koço Gliozheni", por që nuk donte të identifikohet, i tha BIRN se nuk mund ta përballojë më të punonte në ato kushte.

"Ata që po qëndrojnë ende në atë shërbim janë heronj, ju nuk e imagjinoni dot se si punohet aty," tha mjekja.

"Unë për vete nuk munda të punoja më në ato kushte skandaloze, ishte e papërbalueshme psikologjikisht të mos mundesh të ndihmohesh një fëmijë se nuk ka



aparatura spitali, ndaj u largova," shtoi ajo.

Edhe 4 mjekët e mbetur në këtë shërbim duke se po arrijnë pikën e tyre të vllimit, dhe në një shkresë të 20 nëntorit për drejtorin Genci Hyska, kërcënojnë dorëheqjen kolektive, duke nënvizuar se prej 2 vitesh janë sforcuar në pritje të një zgjidhje konkrete.

"Është paralajmëruar në relacionet e mbarëvajtjes së punës në repart që mungesa e personelit mjekësor kërcënon seriozisht sigurinë dhe cilësinë e shërbimit ndaj pacientit," shkruajnë mjekët.

"Meqenëse nuk kemi asnjë zgjidhje konkrete, ndjehemi të detyruar t'ju njoftojmë se kjo situatë është bërë tashmë e papranueshme dhe e patolerueshme - ne shumë shpejt do të detyrohem të japim dorëheqjen kolektive," paralajmërojnë ata, duke u lutur që të ndërmerrin hapa për mbushjen e vakancave.

Megjithatë, Tushe nënvizoi që rekrutimi i mjekëve të rinj në një kohë të shkurtër nuk është i thjeshtë.

"Unë ia kam thënë Ministrisë së çfarë duhet të bëjë, por problemi është se këta i bëjnë strategjitë dhe i mbyllin në sirtar," tha ai. "Një mjek neonat duhet të planifikohet 5 vite më parë, kurse këtu tek ne hapen konkurset dhe nuk vjen askush - duhet mbështetje dhe stimul," shtoi Tushe.

Braktisja e materniteteve të rrethëve

Sipas të dhënave të raportuara nga INSTAT dhe dy qendrat universitare spitalore obstetrikogjinekologjike "Koço Gliozheni" dhe "Mbretëresha Geraldinë", më shumë se një e treta e lindjeve në vendndodhën në këto dy maternitete.

Materniteti "Mbretëresha Geraldinë" deklaroi 7120 lindje të reja, ndërkohe që numri i foshnjave që ndërruan jetë në këtë spital deri në një muaj pas lindjes është 38 . Për periudhën janar-qershor 2018, ky maternitet regjistroi 3117 lindje të reja, ndërkohe që kanë ndërruar jetë 25 prej tyre, përkundër 445 rasteve që kanë pasur nevojë për reanimim neonatal.

Nga ana tjetër, materniteti "Koço Gliozheni" raportoi mesatarisht 4500 lindje përgjatë vitit 2017, ndërkohe që në repartin e kujdesit intensiv janë shtruar gjithsej 957 të porsalindur. Ndër fëmijët e shtruar në këtë repart, vetëm 630 neonatë janë të lindur në këtë maternitet, ndërsa 327 të

tjerë janë të ardhur prej rrethëve, ose të rikthyer.

Gerta Hagen, drejtoreshë ekzekutive e Fondacionit Spitalor i Nënës dhe Fëmijës, i cili që prej vitit 2014 operon në maternitetet "Koço Gliozheni", "Mbretëresha Geraldinë" dhe tani po bashkëpunon edhe me maternitetin e Fierit, shprehet se megjithë problemet që kanë spitalet universitare, ato nuk mund të krahasohen me katandisjen e materniteteve rajonale.

"Do të gënjenim nëse do të thonim që nuk ka probleme, por unë nuk kam parë mjekë të neglizhojnë punën, të paktën në neonatologji," tha ajo. "Nëse i krahasojmë dy maternitetet e Tiranës, ata janë "Sheratonit" në krahasim me maternitetet rajonale," shtoi ajo.

#### KUSHTET E PUNES

Sipas shefit të shërbimit të Neonatologjisë, Edi Tushe, mungesa e kushteve në punë po sjell largimin e mjekëve specialistë dhe të infermierëve. Vetëm gjatë 2018-ës kanë dhënë dorëheqjen nga posti i mjekut neonat në këtë maternitet 3 mjekë.

mjekë të dalë në pension," tha ai.

Ministria i tha BIRN nëpërmjet përgjigjes zyrtare se në maternitetin e Durrësit ka 10 inkubatorë. Por edhe kjo e dhënë rezultoni e pasaktë.

"Neonatologjia pajisjet i ka të mira, por duhen edhe më të mira akoma, pasi koha evoluon. Sepse kur i përdor gjërat, ato normalisht do vijë një ditë që duhen rinovuar. Ne kemi dy ekografi, por duhet edhe një tjetër. Kemi kërkuar gjithashtu edhe monitor, megjithëse në repartin tonë figurojnë tre të tillë. Inkubatorë kemi 6, tre funksionale dhe tre më të vjetër që na shfaqin herë pas here probleme, duke u prishur; ndaj i kemi kërkuar Ministrisë së Shëndetësisë edhe 3 të tjerë," tha Arjan Prodani, drejtori i maternitetit të Durrësit.

Në maternitetin e Durrësit

Kujtim Albrahimi, përgjegjësi i maternitetit bashkiak të Librazhdit.

"Në fakt duhet edhe një inkubator tjetër, duke parë numrin e lindjeve në maternitetin tonë. I kemi bërë kërkesa edhe Ministrisë së Shëndetësisë, jo për ta bërë pa faj, por mbase edhe Ministria kaq ka mundësitë," shtoi ai.

Mungesat e mjekëve dhe aparatrave spitalet rajonale dhe bashkiake po sjellin gjithashtu pasoja fatale për pacientët.

Vetëm pak ditë më parë, më 7 dhjetor në Bulqizë, një grua shtatzënë humbi trinjakët e saj. Spitali nuk kishte mjek dhe lindja e parë është pritur nga një infermiere, derisa ka mbërritur me emergjente nga Tirana ekipi i mjekëve ekspertë.

"Materniteti nuk kishte asnjë kusht, ndaj ne shkuan për të ndjekur shtatzaninë në Tiranë, madje më 8 dhjetor kishte kontrollin e radhës. Ata thjesht më thanë se lindi përpara kohe, por Bulqiza nuk ka asnjë mjek gjinekolog, këtu ka mbaruar çdo gjë," tha Perit Rexhepi, bashkëshorti i saj, ende i traumatizuar nga ngjarja, që sipas tij mund të ishte evituar.

Drejtori i Spitalit Bulqizë, Hazis Jella i pyetur në lidhje me rastin në fjalë, i tha BIRN se staffi bëri të gjithë përpjekjet dhe grupi nga Tirana erdhë shumë shpejt, por ishte i pamundur shpëtimi i foshnjave për shkak edhe të moshës së tyre të vogël. Jella nuk dha përgjigje në lidhje me mungesën e mjekut obstetërgjinekolog në këtë maternitetit.

"Ne kemi mjekë që shërbejnë për çdo lloj urgjencë, këto janë kapacitetet tona," sqaroi ai.

Për Gerta Hagen, handikapi qëndron tek mungesa e sistemi i referimit, i cili jo vetëm do të jepte një panoramë të qartë se çfarë diagnostash mund të trajtojë çdo spitali qoftë rajonal, qoftë bashkiak, por një gjë e tillë do të ulte mbingarkesën edhe në spitalet Tiranës.

"Nuk kemi një protokolli të mënyrës se si rastet referohen. Në gjithë botën nuk ka spitalet rajonale të specializuara për çdo gjë, por ke qendra të specializuara të grumbulluara," tha ajo. "Për mua sistemi i referimit do të ishte një ndër masat më me sens në ruajtjen e shëndetit," shtoi ajo.

Ish-ministri i Shëndetësisë, njsherazi gjinekologu i njohur Halim Kosova i tha BIRN se mungesa e aparatrave është një çështje serioze, por që zehet për nga rëndësia në krahasim me largimin e mjekëve.

"Sa më shumë inkubatorë, aq më mirë normalisht. Nëse një spital nuk ka mjek, ai spital nuk ka se çfarë të porosisë," tha ai.

"Për spitalet e rrethëve duhet të bëhet një përllogaritje të lindjeve për të hapur më pas diskutimin nëse duhet të mbahen apo jo këto spitalet," shtoi Kosova.

Edi Tushe nënvizoi se sugjerimet për zgjidhje nuk kanë munguar, por vullneti i autoriteteve për t'i zbatuar ato është shterpë.

"Ministria e Shëndetësisë e di se çfarë duhet bërë. Kam qenë pjesë e grupit të punës që ka hartuar strategjinë për shëndetin riprodhues, e cila përfundoi vjet, dhe aty ka një kapitull të veçantë për vdekshmërinë foshnjore," tha ai.

"80% e vdekshmërisë foshnjore janë neonatë dhe pa ndërhyrë në këtë shërbim, rrezikojmë të bëjmë hapa prapa sa i përket këtij treguesi," paralajmëroi Tushe.

## EKSPOZITA



# KRISTO KRISIKO

## Madhështia e artistit që e nisi nga fabrika e porcelanit

Nga Fatmira Nikolli

**K**anë kaluar vite nga koha kur Kristo Krisiko, punonte si piktor në fabrikën e porcelanit në Tiranë në vitet 1958-1968. Ishte koha para se të studionte në Departamentin e Arteve të Aplikuara në Institutin e Lartë të Arteve të Tiranës (1969-1973). Një ekspozitë e çelur dy ditë më parë në Galerinë e Fakultetit të Arteve të Bukura sjell një përmbledhje të krijimtarisë së tij.

Pas diplomimit, ai do të përqendrohej në keramikë, duke zgjeruar punën e tij edhe me skulpturën. Puna e tij është e njohur më së shumti për stilizimin e figurave dhe për ndërlikimin e modeleve gjeometrike.

Duke nisur me projektin skulpturor në keramikë të Bankës së Shqipërisë, që daton në fund të viteve '80-të e deri në të përditshmen tonë postmoderne, Kristo Krisiko vjen para publikut me një ekspozitë ku lamia e veprave rrok disa kohë. Për kuratorin Ardian Isufi, veprat, fillimisht duken si një arratisje volumesh pa adresë, por që gjithmonë kthehen në destinacione kompozicionale të mirë shënjuara. "Materia e formës tokësore ndërthuret me forma kozmologjike, sikur shkelin 'njerëz të rinj në tokë të lashtë' nëpërmjet një futurizmi më shumë mental sesa estetik", shton Isufi, për të cilin, shfaqet kështu një art pamor pas rënies së komunizmit, një arratisje që sipas autorit shpie drejt artit Helen, pranë dhe afër njëri-tjetrit. Ndryshe nga kolegët e tjerë që paraqisnin një njeri të ngrirë, sa madhështor dhe paradoksal, art të blatur nga megalomanitë e një sistemi paranojak dhe



*Ekspozita në Galerinë "FAB", "Prolog" kur rri larg njeriut të ri*

diktatorial, sipas Isufit kjo nuk ndodhi me Kristo Kristikon në 'njeriun e ri socialist'. Në ekspozitë dhe ne veprat e Krisikos, ndjehet jo vetëm ana njerëzore por edhe lëvizja e njeriut të



thjeshtë, me brishtësinë e vet dhe intimitet i njeriut me artin.

Gjatë hapjes, teksa u tha se shumë artistë nëpërmjet 'Realizmit Socialist' donin të ngrinin vetveten, përmes pompozitetit që shfaqte një metodë arti në skulpturë, sipas Isufit, ai ngriti njeriun.

Kuratori tjetër, Sadik Spahija, tha se janë vepra të dimensioneve të ndryshme në skulpturë. Janë punime, që janë realizuar para dhe pas viteve '90. Kristo Krisiko ka një aktivitet të njohur prej vitesh. Veprat e tij në ekspozitë janë vendosur jo vetëm brenda galerisë, por dhe jashtë.

"PROLOG" i një kronike të paralajmëruar që zhvillohet përgjatë një eksperience të gjatë artistike, vjen në krijimtarinë e Kristo Krisiko si një sintezë e qenies humane e përshkruar në mënyrë të dritë në kohë dhe hapësirë.

Hapësira kohore parë në rrafshin historik shtrihet në dekada të jetuara para-pas viteve '90-të me shpërthime halucinante të saj që fillimisht vinin si shkak-



pasojë e izolimit komunist nën trysinë e rregullit të realizmit socialist të kushtëzuar në artet pamore duke u pasur në vitet e demokracisë në një arratisje në tokën helene, pra larg afër vendit të tij.

Qendra e qendrës në veprën e tij është figura femërore që sendërtohet në forma poetike dhe në të vërtetat e saj humane. Camille Clodel nën një analizë të mprehtë dhe radikale thotë: "Roden, ti je skulptor dhe jo skulpturë." E pra, nëse shumë kolegë të tij sidomos në periudhën e realizmit socialist paradoksalisht rëndën të ngrenë monumentin e vetes së tyre nën efektin e temave të mëdha të "njeriut të ri socialist", ndodh e kundërta në krijimtarinë e Krisikos me çiltërsinë dhe modestinë e tij artistike duke prezantuar marrëdhënien njerëzore pothuajse në një rrafsh intim.

Koleksioni që prezantohet në këtë ekspozitë e përmbledh këtë frymë liricë në çdo kohë apo periudhë të tij duke nisur me projektin skulpturor në keramikë të Bankës së Shqipërisë që daton në fund të viteve '80-të e deri në të përditshmen tonë postmoderne.

EPILOG i një metamorfoze formash të abstraguara, apo thënë ndryshe "forma në zhvillim" shfaqin një qasje pothuajse të re në rrugëtimin e tij artistik të viteve të fundit. Skulptura ka një dimension tjetër në kërkim duke evidentuar më shumë procesin e formave në lëvizje sesa aspektin figurativ. Fillimisht duken si një arratisje volumesh pa adresë por që gjithmonë kthehen në destinacione kompozicionale të mirëshënjuara.

Materia e formës tokësore ndërthuret me forma kozmologjike, sikur shkelin 'njerëz të rinj në tokë të lashtë' nëpërmjet një futurizmi më shumë mental sesa estetik.



## BOTIMI

# "E veçanta e dhjetorit", kur makutëria kthehet në normalitet

Romani i Donal Ryan i përthyer nga Renato Kalemi Zhanri sjell një histori, sa të ëmbël, aq dhe të hidhur, që na kujton se në jetë jemi të rrethuar nga shpirtira të thjeshtë, të cilët shpesh janë më të thellë e më të mençur se ç'mund të mendojmë.

Romani "E veçanta e dhjetorit" rrëfen një vit nga jeta e Xhonsi Kanlajfit, një djaloshi i vetmuar, pa përvojë, pa miqësi apo ambicie, që jeton në po atë zonë rurale të Irlandës ku ndodhin ngjarjet e romanit "Zemra vërtitëse". Shkruar nga i njëjti autor. Megjithatë i botuar pas këtij të fundit, ngjarjet e paraqitura në romanin "E veçanta e dhjetorit" janë më të hershme: ato zhvillohen para krizës financiare të vitit 2008, që përfshiu jo vetëm Irlandën, por gjithë Europën. Romani është i ndarë në 12 kapituj, ku në secilin prej tyre përshkruhet një muaj nga një vit jetë e Xhonsit. Teksa ekonomia e vendit është në vllim dhe makutëria kthehet në normalitet, Xhonsi përpjetet dëshpërimisht të ruajë atë çka i është familjare, e njohur dhe e ngrohtë, megjithëse ndërkohë ka humbur të gjithë ata që e kanë mbrojtur nga egërsia e jetës. Pas vdekjes së prindërve, Xhonsi trashëgon fermën e familjes dhe një llogari bankare të majme, megjithëse është i paaftë për t'u kujdesur për to. "Gangot" e fshatit dhe mashtrues të ndryshëm e përndjekin, e megjithëse copëza dashurie hyjnë në jetën e tij në vendin dhe kohën më të çuditshme, Xhonsi mbetet



Romani i Donal Ryan në shqip, rrëfimi para krizës financiare më 2008

njeri i vetmuar, i cili ka vështirësi të rrijë pas botës që lëviz me ritme marramendëse. Në rrëfim gjurmohen me zgjuarsni shkaqet fillestare të rritjes së pakontrolluar të çmimeve të pronave të patundshme, të vuajtjes së shumë të pafajshmëve, si dhe shfaqet shkatërimi i komuniteteve, që dikur jetonin në harmoni.

Vepra ka qenë finaliste e çmimit 'Romani i Vitit' në Irlandë dhe finaliste e çmimit 'Kerry Group Irish Novel of the Year'. Për kritikën, Donal Ryan është një shkrimtar-magjistar. "Ka një aftësi aq magjepsëse për të rrëfyer një histori, sa ta ka ënda ta lexosh me zë të lartë. Ky roman do të mbushë zemrat e do të pasurojë shpirtat

e lexuesve", shkruante "The Guardian". Ndërsa për "The Irish Times" romani përligj plotësisht suksesin që arriti romani i tij i parë, duke analizuar më tej tensionet e pranishme në zemër të jetës rurale, pa lënë asnjëherë përshtypjen se kërkon të kritikojë.

Kritika shkruan se libri i shpie lexuesit në mendjen e një njeriu që ka vështirësi të çajë në një botë, të cilën nuk arrin kurrë ta kuptojë plotësisht.

Nëse romani i parë i Donal Ryan "Zemra vërtitëse" ishte kandidat për Man Booker Prize dhe fitoi çmimin "Libri i vitit, 2012" në Irish Book Awards, çka shihet si një fillim jo i keq për karrierën letrare, e vetmja anë negative ishte

dërvjellësi madje, dëshmon se kemi të bëjmë me një prej shkrimtarëve të rinj më të talentuar bashkëkohorë", shkruante "The Independent". Autori Donal Ryan (1976) është një ndër shkrimtarët irlandezë bashkëkohorë më premtues. Ai ka lindur në Nenagh, në Kontenë Tipperary, në Irlandë. Ka qenë nëpunës i sektorit publik për shumë vjet. Dhe vetëm më 2014, pas suksesit që korri "Zemra vërtitëse", romani që e shkroi gjatë mbrëmjeve të verës së 2010-ës, i është kushtuar tërësisht krijimtarisë letrare. Romani i tij i parë u refuzua nga 47 botues, derisa më në fund arriti të gjente një të tillë. Dy romanet e tij të para "Zemra vërtitëse" dhe "E veçanta e dhjetorit" kanë arritur majat e kritikës irlandeze dhe europiane. "Zemra vërtitëse" ka fituar The Guardian First Book Award, Çmimin European për Letërsinë (2015), titullin "Libri i Vitit" në Çmimet e Librit Irlandez. Donal Ryan është diplomuar në Universitetin e Limerick-ut. Ai jeton me bashkëshorten, Anne Marie, dhe dy fëmijë e tyre në rrethinat e Limerick City Fragmente nga libri 1) ...një gënjeshtër në letër duket më e vërtetë sesa e vërdeta e shprehur nga goja e një budallai. 2) Njerëzit çfarë nuk thonë kur mendojnë se kanë të drejtë. 3) Në njëfarë mënyre, të gjitha bisedat janë të gënjeshtërt. Vetëm veprimi i bën ato të vërteta. Të gjitha fjalët janë gënjeshtër, në mos ajo për çka flitet i vihet tjetrit përpara, që ky ta shohë ata prekë. Gjërat që thuhesh në celular dhe ato që shkruhen me bojë në letër për t'u lexuar nga të gjithë e mandej ndryshohen, s'mund të merren për bazë as tani, as kurrë ndonjëherë.



se ai përveshi mëngët për sfidën e romanit të dytë. "Fakti që ai ia doli mbanë, dhe me shumë zh-

## ÇAPALIKU PROMOVON NË KOSOVË "SECILI ÇMENDET SIMBAS MËNYRËS SË VET"

Në mjediset e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës është promovuar vëllimi më i ri, i tretë me radhë, i romanit "Secili çmendet simbas mënyrës së vet" i autorit shkollor Stefan Çapaliku.

Sipas publicistit Agron Shala, romani "Secili çmendet simbas mënyrës së vet" i takon zhanrit letrar që në kulturën perëndimore njihet si "Bildungsroman" apo "coming-of-age", zhanër ky që merret me formimin e personalitetit të protagonistit në aspektin psikologjik e moral nga mosha e re deri në moshën

e pjekurisë, shkruan RTK.

Dy vëllimet e para, që kryesisht portretojnë karaktere e japin ngjarje që kanë ndodhur në Shkodër e përreth saj në kohën e regjimit të egër komu-

nist, e që shpesh përcillen edhe me një shtresim të humorit të këndshëm, kanë gjetur lexuesin e vet, madje janë përkthyer në disa gjuhë të huaja.

Çapaliku tha se nëse ky ro-



man do të ketë një vëllim të katërt, atëherë do të merret me Facebook, pasi në vëllimin e parë është marrë me televizionin, e njerëzit po çmendeshin shumë lehtë. Ai shtoi se në kohën e regjimit, librat e parë i preku në Prishtinë, sepse në Shqipëri ishin të ndaluar. Të gjitha këto kujtime e bënë të shkruajë dy vëllimet e romanit "Secili çmendet sipas mënyrës së vet", dhe se është akoma më i lumtur që po e bën këtë promovim pikërisht në Prishtinë.

Autori, Stefan Çapaliku, që është edhe poet, dramaturg e studiues e ligjërues i letërsisë, theksoi se ngjarjet që dëftohen në të gjitha vëllimet e romanit të tij, janë ngjarje të përjetuara nga ai vetë dhe të kaluara

nëpërmjet mekanizmit krijues të tij, por nuk janë ngjarje fikzionale apo të improvizuara. Para auditorit, Çapaliku dëftoi se gjenerata e lexuesve që ka jetuar në atë kohë, e lexon romanin si dëshmi e faktografi e kohës, ndërsa gjeneratat e reja e lexojnë si krijim fikcional duke mos besuar se ngjarje të tilla do të kenë mundur të ndodhin e të jenë të vërteta. Çapaliku konfirmoi se ai do të shkruajë edhe vëllimin e katërt të këtij romani, që do të jetë edhe vëllimi i fundit.

Edhe vëllimi i tretë, si dy të parët, është botuar nga Enti Botues "Gjergj Fishta" i Tiranës nën përkujdesin e Frano Kullit

Opinion

i Ditës

# Për kë bien këto kambana...?!

Prof.Asc.Dr.Rezana Konomi

(vijon nga faqja 1)

... përfundojnë po të tilla nëpër të gjitha studiot e tv, të cilët rëndin për të kapur lajmin, ngritur pyetje, e për të dhënë përgjigje, shpesh edhe si për të ngatërruar mendjet njerëzore me "teori konspiracioni", për të gjetur ujkur kur gjurmët kishin kohë që shëtisnin nëpër të gjitha rrugët e qytetit, duke trokitur e dukë u fshehur në çdo vatër shqiptarë. Duhet vetëm një shenjë, një zhurmë dhe gjithçka do të zgjohej dukë ulëritur me thirrjet therëse që trembin të madh e të vogël.

Ky ishte realiteti që fshihte pas njëmijë të pathëna. Por padyshim më së shumti të njohura nga gjithë pjesa akademike, studentët dhe vetë politikëbërësit që sot falënderojnë ironikisht studentët, që u hapën sytë për të parë të vërtetat dhe realitetin e mbytur, që ka pak gjasa për t'u shpëtuar.

Kush bën sikur nuk di që arsimi ka 28 vite që lëngon është dashakeqës, ose në rastin më të mirë i verbër dhe i shurdhët. Ka 28 vite që eksperimentohet me reforma të njëpasnjëshme, të dështuara që në lindje dhe askush nuk ka mbajtur përgjegjësinë minimale, sepse për faje as që bëhet fjalë, megjithëse dukë i vënë shkelmin arsimi i kë bërë gropën vetë kombit.

Cdo parti që ka ardhur në pushtet dhe çdo ministër që ka drejtuar këtë tempull të dijes (sepse kështu duhet të ishte), ka nxituar të vendosë dekorata për risitë në zhvillimin e arsimit dhe shkencës, dukë filluar që nga ndryshimi i shpeshtë i programeve, alter-teksteve mësimore, i ndryshimit të drejtuesve, duke rrekur gjithë dynjanë për drejtues gjoja më merrita profesioniste, të zgjedhur me konkurse dhe jashtë bindjeve partiake. Dhe ky cikël është përsëritur pa pushim, në gjithë këta vite dhe arsimi si çdo vatër dhe qelizë tjetër e kësaj shoqërie, u pushtua dhunshëm nga partitë, të cilët i kishin si njësi militantësh dhe tribuna për të siguruar vota dhe për të diktuar dhe shantazhuar të madh dhe të vogël.

Natyrish në periudha afatshkurtra gjithë pushtetarët janë të velur nga frytet që marrin nga këto cuazi reforma në arsim, por dardha e ka bishtin mbrapa. Dhe vjen një ditë kur megalomania nuk i fsheh dot të gjitha të vërtetat, kur populizmi nuk të shërben më, sepse kur ato dalin në dritë nuk ka dritë tjetër, madje as ndricimi i poqeve festive që të mund të mbulojë të keqen që po ulërit në grahamat e fundit.

Reforma në arsimin e lartë, ka qenë kali i betejës për çdo maxhorancë dhe për maxhorancën aktualë është vlera më e madhe, mburrja së kjo që po ndodhtë ishte hera e parë në arsimin e lartë, që do të ndryshonte thellësisht



vetë sistemin.

Në fakt, ligji për arsimin e lartë ka qenë që në krye të herës, ligji më i debatuar dhe më i kundërshtuar nga gjithë aktorët dhe faktorët, por asnjë vërejtje nuk u dëgjua, asnjë gërmë nuk u ndryshua këtij ligji, sepse ekspertët e huaj që punuan për të u serviren si personalitete, të cilët nuk mund të kundërshtoheshin. Më gjithë respektin për profilin e tyre profesional, dua të them se ekspertiza e tyre ishte një mentalitet dhe një filozofi që vinte nga një realitet krejt tjetër me realitetin tonë, më së shumti i panjohur për ta, ishte si të injektoje një ilaç të mirë, por në një trup të gabuar dhe për këtë arsye nuk mund të funksiononte. Të gjithë në që jemi pjesë e këtij sistemi, ndeshim përditë vështirësi, ndërçesje e vakume, që burojnë nga vetë ligji, për të mos përmendur këtu mos nxjerrjen edhe sot e kësaj dite të kuadrit të plotë nënligjor, megjithëse janë tejkaluar të gjitha afatet ligjore.

Mungesa e investimeve për të siguruar kushte minimalë studentëve, apo sigurimi i kartës studentore, tarifave të studimit, janë

Më vjen keq ta pohoj, por edhe pas 28 vitesh në demokraci, ky nuk është shteti që në ëndërruam, nuk është realiteti që kemi zgjedhur për të jetuar jetët tona, të paktën deri tani, nuk është e ardhmja që u duhet fëmijëve tanë.

shumë të rëndësishme për vetë procesin e të nxënës, por janë vetëm njëra anë e problemit. Sot arsimi i lartë (nuk dua të përmend kërkimin shkencor, sepse më duket një perspektivë akoma e paskequr), është në ditët më të këqija, sepse është cenuar rëndë cilësia, thelbi, të cilat nuk mund të zgjidhen as më masa gjysmakë dhe as më dialogët e munguara. Keqadministri, përdorimi jo eficient i fondeve, shpesh mungesa e tyre, shpërdorimi deri në veprime abuzive dhe korruptive, i dhanë shenjat e para sapo ligji hyri në fuqi, por askujt nuk iu shqetësua gjumi dhe rehatia. Atë ishin kambanat e para paralajmëruese për gjithë drejtuesit e këtyre institu-

cioneve dhe vetë ministrinë përgjegjëse.

Përgjigjja e përsëritur e pyetjeve tona për çdo kontestim të këtij ligji; se duhet kohë për të kuptuar efektet e vërteta të tij; besoj se tashmë i ka ardhur koha, për të bërë analiza dhe për të nxjerrë përgjigjësit. Këto janë efektet e paefektshme, të cilat nxorën në dritë një realitet të dështuar, një mungesë të theksuar koordinimi dhe llogaridhënie, transparence, e përgjegjshmërie e përgjegjësie.

Nuk mjafton një shkrim, si një reflektim i ngjarjeve të ditëve të fundit për të treguar problemet e arsimit të lartë, ato që lidhen më të drejtat dhe detyrimet e studentëve nga njëra anë dhe profesionalizmin dhe cilësinë e munguar të stafëve akademike nga ana tjetër. Ka qark shumë për të thënë, e për të bërë, sepse e tillë është sëmundja kancerogjene nga e cila vuan sot arsimi në përgjithësi dhe arsimi i lartë në veçanti, më tentakula të shtrira gjithandej dhe për këtë arsye kërkohet një ndërhyrje operationale thellësisht rrënjësore, për t'u marrë më shkaku dhe jo pasojën.

Ndërkohë që problemet janë aty

dhe presin për zgjidhje, ajo që më shqetëson sot, është përballja e tyre me arrogancën dhe mungesën e transparencës, si dy elemente shumë të rëndësishëm të demokracisë dhe shtetit të së drejtës.

Arroganca për të bërë atë që dua unë dhe ashtu siç dua unë, monologët e pafund në diskutet e pashterura, funksionimi i shtetit në mënyrë virtuale, më hidh e prit ironi e sarkazëm nëpër rrjete sociale, kanë krijuar dy realitete shqiptare larg njëri-tjetrit; atë të vërtetin që politikanët tanë (të cilëve u kemi deleguar përfaqësimin) fatkeqsisht nuk e njohin dhe as që duan ta njohin, madje kur e dëgjojnë çuditën: dhe realitetin dixhital, që duan ta besojnë dhe që ekziston vetëm nëpër mendjet e tyre.

Më vjen keq ta pohoj, por edhe pas 28 vitesh në demokraci, ky nuk është shteti që në ëndërruam, nuk është realiteti që kemi zgjedhur për të jetuar jetët tona, të paktën deri tani, nuk është e ardhmja që u duhet fëmijëve tanë.

Dua ta mbyll më një thënie të mençur të një njeriu të moçëm: Nëse do të bësh plane për 100 vjet, mbill arsimin (Konfuci)...E di që është pak si shumë për pushtetarët tanë të mendojnë në mënyrë kaq vizionare, por të paktën kur mbillni shkurre mos na e shisni për palma, sepse ndërgjegjja qytetare dhe reagimi sapo është zgjuar, mos luani më to!

Ju lutem, veproni sot, nuk ka asgjë më të rëndësishme se dija, nuk ka kohë për nesër, na pengoni të bëjmë gati valixhet, është vendi ynë dhe i të parëve tanë dhe që duam vërtet ta trashëgojmë.



Opinioni *i* Ditës

# Të gjithë halldupët e politikës shqiptare rrëzohen po njëllor

Nga Spartak Ngjela

(vijon nga faqja 1)

... e çmendurisë dhe pas disa vjetësh do ta shohim të çmendur nëpër rrugët e Tiranës..."

Enver Hoxha u çmend realisht, por nuk e lanë që të dilte si i marrë nëpër rrugët e Tiranës. Viktimë e marrëzisë së Enver Hoxhës u bë pasardhësi i tij, Ramiz Alia, sepse këtij iu ngritën studentët.

I Ramë ziu, në këtë fillim të disgracies së tij, po e pëson njëllor si Ramiz Alia që, pasi iu ngritën studentët, nuk shkonte dot askund gjatë vitit 1991, se ishte i përbuzur nga shoqëria shqiptare. Gjithësesi, ai e dinte dhe nuk doli nëpër salla të rregulluara me fanatikë të tij. Ky, ndryshe nga Enver Hoxha, nuk ishte i shturur nga mendtë e kokës dhe e dinte mirë se me studentët e kishte krejt fare të pamundur që të takohej. Dhe nuk doli.

Sigurisht që Alia ishte shumë mbi nivelin e Ramës, por ishte i diskredituar politikisht nga tirania e krimit shtetëror Hoxha, së cilës i shërbeu deri në fund.

Por Rama nuk e kupton dot këtë, se nuk e lë frika dhe çoroditja mendore e ngjashme me atë të Enver Hoxhës. Prandaj është edhe më keq, shumë më rëndë se Ramiz Alia.

Tani Ramës studentët, kur ky iu afrohet, i bëjnë 'Yyyy'. Gjë shumë e rëndë kjo dhe e pandodhur më parë. Studentët e kësaj kohe kuptohet se janë me formim modern, por çoroditja mendore Rama, këtë nuk ka si ta kuptojë. Do ta tmerrojë ky fakt, por nuk do t'i shpëtojë dot më 'Yyyy'-së së zgjatur të studentëve.

ll. Kjo është arsyeja që po shohim se Rama është në një situatë shumë të rëndë psikike. Kuptohet nga sjellja. Njëllor si Enver Hoxha në vitet 1982-1985 kur degradoi, por nuk e lanë të dilte në jerm nëpër rrugët e Tiranës. Prandaj ka tepër gjasë që po të vijojë kështu, këtë kryeministër, ndryshe nga Enver Hoxha, mund ta shohim si të marrë që do të dalë rrugëve të Tiranës.

E keni parë se çfarë marrëzish flet nëpër salla kryeministri aktual! Asnjë ide. Asnjë skemë zhvillimi. Nuk ka lidhje fare me shtetin që mendon se po e drejton. Dhe çfarë bën?

Mëson studentët sesi të ulen për ta dëgjuar sikur të jetë një mësues i klasës së parë fillore. Merrret me duartrokijtë e sallës. Nuk ka asnjë program për arsimin dhe kuptohet që ka qenë dhe vijon të jetë pjesë e degradimit sistematik që po i bëhet në mënyrë korruptive arsimit shqiptar.



Kështu ka qenë edhe Sali Berisha në lidhje me sistemin arsimor të Shqipërisë. Të jetë vallë rastësi ngjashmëria e tyre!

Por, Rama është i ndërkrayer dhe i duket sikur po humbet jetën. Në fakt, ka diçka tjetër brenda vetes që e shqetëson deri në këtë gjendje: ka frikë nga SPAK-u, që tani po shkon drejt përfundimit të ngjashmërisë së tij institucionale. Mendon nën frikën e gjithëshme që po e sundon.

Prisni, se ky është vetëm fillimi, sepse Rama nuk po përplaset vetëm me studentët për arsimin. Ai në fakt po përplaset me varfërinë shqiptare, që ka krijuar ai dhe paraardhësit e tij.

Enver Hoxha u çmend realisht, por nuk e lanë që të dilte si i marrë nëpër rrugët e Tiranës. Viktimë e marrëzisë së Enver Hoxhës u bë pasardhësi i tij, Ramiz Alia, sepse këtij iu ngritën studentët.

Në Europën moderne pasurimi i Edi Ramës nga hiçi familjar është pamundësi absolute, se të pret burgu. Atëherë? Ja kjo është frika e tij, por kudo ku të shkojë, 'Yyyyy' do t'i bëjnë gjithkund - kudo ku ai do të përplaset me studentët. Por, a do ta durojë dot?

Ka shumë kusure në lidhje me korrupsionin Edi Rama, sepse deri para dy vjetësh e ka ditur si një gjë të ligjshme pasurimin e një kryeministri që doli në politikë nga varfëria.

Kurse studentët ia kujtuan dje:

"si e bërë vilën", i thanë. Po ka turp më të madh për një kryeministër varfanjak që të bëjë vilë private, duke qenë kryeministër i një populli që është varfëruar nga kryeministria hajdutë, që nuk kanë lënë gjë pa bërë kundër vendit dhe popullit të vet?!

Në Europën moderne pasurimi i Edi Ramës nga hiçi familjar është pamundësi absolute, se të pret burgu. Atëherë? Ja kjo është frika e tij, por kudo ku të shkojë, 'Yyyyy' do t'i bëjnë gjithkund - kudo ku ai do të përplaset me studentët. Por, a do ta durojë dot?

## HOROSKOPI

### DASHI

Nuk do të keni një ditë të lehtë përpara. Do të përballemi me konflikte gjatë ditës, për të cilat do të jetë shkak sjellja juaj. Ndaj do të ishte mirë të mbanit veten nën kontroll dhe të mendoni me qetësi. Vetëm kështu mund të tërhiqni fatin e mirë në disa fusha të jetës.

### DEMI

Mund të zhgënjeheni gjatë ditës së sotme. Do të debatoni me partnerin/partneren pasi ka gjasë që ai/ajo të nisë një marrëdhënie të re me dikë tjetër. Megjithatë kjo nuk do të thotë që ju të rëndoheni psikologjikisht. Një opion shumë më i mirë është argëtimi.

### BINJAKET

Shumë Binjakë do të kuptojnë sot diçka për të cilën kanë luftuar në të kaluarën. Kjo do t'ju ndihmojë shumë të ecni përpara. Studimet nuk do t'ju shkaktojnë lodhje dhe do të keni vullnetin t'i përfundoni të gjitha detyrat e nisura.

### GAFORJA

Gaforet duhet të bëjnë shumë kujdes për shëndetin. Ndoshta duhet të anuloni planet për në mbrëmje, për t'iu përkushtuar më shumë shëndetit. Kjo ditë nuk do t'ju favorizojë aspak për t'iu përkushtuar punës.

### LUANI

Do të jeni shumë të përkushtuar ndaj gjëjes së dashurisë. Ndërsa personat e martuar të kësaj shenje, do të kalojnë një ditë fantastike nën praninë e partneres/partnerit tuaj. Mos u nxitoni kur të ndërmerrni një vendim të rëndësishëm gjatë ditës së sotme.

### VIRGJERESHA

Do të ndihen të irrituar. Ndoshta arsyeja mund të jetë një lajm jori ose një debat në familje. Mbrëmjen do ta kaloni me më pak stres. Ka gjasë të bëheni pjesë e një eventi argëtues. Këshillohet të mos eksperimentoni me alkolin dhe ushqimin.

### PESHORJA

Disa Peshore do të rrisin buxhetin e familjes. Dita do të kalojë pa stres. Do të keni vizita nga disa persona që nuk i takoni prej kohësh. Madje, ka gjasë që të merrni një telefonatë nga dikush që iu ngjall mjaft kujtime.

### AKREPI

Akrepët sot do të krijojnë situata shumë të këndshme dhe argëtuese. Në punë do të merrni përshlyetje të mira. Ka mundësi të keni një komunikim me shefin, i cili mund t'ju premtojë rritje të pagës.

### SHIGJETARI

Shigjetarët nuk duhet të tregohen altruist ndaj të tjerëve sot. Kujtojeni rëndësi vetes dhe problemeve tuaja. Mund të shënoni sukses në karrierë, mund të forconi pozitën tuaj në punë ose mund të zgjidhni disa çështje të vështira të lidhura me burokracinë.

### BRICJAPI

Bricjapët do të kalojnë një ditë të lodhshme dhe nuk do të keni agjendë strikte për të ndjekur. Duhet të organizoni aktivitetet për në mbrëmje. Megjithatë ekziston reziku që të braktisni gjithçka për në mbrëmje pasi mund të mos ndihen mirë nga ana shëndetësore.

### UJORI

Ka gjasë që në disa momente gjatë ditës të flitroni. Pranë jush do të jetë një person shumë tërheqës. Ka gjasë që të bëhet edhe pjesë e zemrës suaj.

### PESHQIT

Duhet të jeni sa më formal në punë, pasi një sjellje e juaja jo serioze mund të ndikojë shumë në vlerësimin ndaj jush. Disa persona të kësaj shenje do të takojnë një të afërm. Do të kaloni një mbrëmje romantike me partnerin/partneren tuaj.



## Trajneri i Kamzës, Gjoka: Gara për mbijetesë është ashpërsuar

Trajneri i Kamzës, Ernest Gjoka ka folur në konferencë për shtyp para ndeshjes kundër Skënderbeut, ku u shpreh se e kanë vlerësuar maksimalisht këtë takim. "Jam munduar të ndryshoj mentalitetin e skuadrës dhe të lojtarëve. Nuk është e lehtë të mos

kesh disa lojtarë, por po mendohejmë t'i rikuperojmë. Sërish kemi dy mungesa, Frashërin dhe Mehmetin me kartonë. Skënderbeu është një skuadër për t'u vlerësuar, pavarësisht humbjeve të fundit. Fitorja e Luftëtarit në Korçë e ashpërsuan më shumë garën për mbijetesë.

Kuptohet, çdo skuadër bën luftën e vet, por ne i presim korçarët në fushën tonë dhe duhet të marrim maksimumin. Ky kampionat është shumë i egër. Këtu kam parasysh se nuk është më ai Skënderbeu që ka qenë gjithë kohën shumë i fortë. Nuk është ai Kukësi që ka

qenë gjithë kohën shumë i fortë. Shoh një Partizan që ka ndryshuar, por sigurisht nuk është Partizani më i mirë i viteve të fundit. Pra, kampionati është gjithnjë i hapur, pavarësisht hapësirave në pjesën e fundit të renditjes. Ne jemi një klub modest dhe brenda kësaj modestie do të përpiqemi të gjejmë ndonjë lojtar për ta përforcuar skuadrën", - u shpreh trajneri Gjoka.

Pa kroatin Bushiç, peshën e sulmit kuqezi do ta mbajë Danilo Alvesh dhe Agustin Torrasa

Jeton Selimi

# Daja: Ndjaj Tiranës dua 3 pikë, Mema është një rival i denjë

Trajneri i druhet neglizhencës së lojtarëve të tij

Trajneri i Flamurtarit, Ilir Daja foli sot në konferencën e zakonshme për shtyp para ndeshjeve, ku garantoi se skuadra e tij do të luajë vetëm për fitore kundër Tiranës, pavarësisht se pranoi se është e vështirë të motivojë lojtarët. Pavarësisht emrit të bardhebluve, situata që ata po kalojnë vitet e fundit ka bërë që në kampin vlonjat t'i druhen më shumë angazhimit të lojtarëve të tyre sesa kundërshtarit. Daja "qan" mungesën e Bushiçit dhe ngarkon me përgjegjësi Alveshin e Torrasën, duke pritur prej tyre që sot ndaj bardhebluve të zgjidhin situatat në sulum.

Luani me Tiranën, skuadër që po vuan në këtë sezon. Është një ndeshje e vështirë për shumë arsye, pasi lojtarët janë jo 100% të motivuar. Kjo në raport me Tiranën nuk është njësoj, pasi ata janë në një pozicion që kërkojnë të ngrihen. Por, edhe ne e duam diçka të tillë, pavarësisht se vijmë nga dy fitore radhazi. Kemi përballë një kundërshtar si Tirana, që pikët e marra nuk tregojnë nivelin e tyre. Ata kanë prodhuar lojë dhe nuk nisemi nga pozicioni që kanë në tabelë.

Thatë se është e vështirë të motivoni lojtarët.

Do e vlerësojmë maksimalisht, pasi janë klubi më i titulluar në vend. Me aq sakam mundur ta ndjek, besoj se Tirana meriton më shumë nga sa ka në tabelën e klasifikimit. Ne vijmë pas dy fitoreve radhazi, por futbollit është i tillë që sapa mbaron një ndeshje, duhet të ruash të njëjtin ritëm, nëse do të shkosh drejt objektivave të vendosur. Ekipet ndryshojnë nga java në javë, jo më nga një fazë. Siç e njoh unë Memën, më njeh edhe ai. Kjo nuk ka të bëjë me faktin që kemi punuar bashkë. Gjërat evoluojnë, çdo ekip ka problemet dhe armët e forta. Nuk ka rëndësi shumë njohja mes njëri-tjetrit, por leximi i lojës gjatë zhvillimit të saj.

### Si paraqitet gjendja e grupit?

Gjatë kësaj periudhe, problematika jonë ka qenë fakti që nuk e kemi pasur



grupin të plotë. Shpesh lojtarët kanë sakrifikuar dhe kanë luajtur jo në gjendjen më të mirë. Jemi mësuar me këtë gjë, as nesër nuk do e kemi të plotë. Mungon Veliu, por edhe Bushiç me

shumë mundësi nuk do të jetë. Ata që kemi kanë shumë eksperiencë, sidomos në sulum ku janë Alvesh, Torrasa e Kale. Nëse do mbështeten mirë, atëherë do ta bëjnë më të lehtë mungesën

### Sulmi atëherë ka një detyrë të vështirë...

Besoj se nuk do ta ketë Alvesh këtë pretendim, pasi në 18 javë kampionat nuk ka qenë prezent në shumë ndeshje. Por kësaj radhe nuk e plotësojmë dot, pasi Bushiç nuk mund të jetë. Sot do shihet konfirmimi. Do futemi edhe nesër në fushë me kontingjentin jo të plotë. Kemi kohë për të qenë të gjithë bashkë. Problematika jonë kryesore ka qenë se nuk kemi qenë me ekipin e plotë. Shpresojmë të jemi në vazhdimësi, pasi jo vetëm rritet rivaliteti, por edhe shprehim potencialin tonë në fushë dhe të kënaqim tifozët me paraqitjen e bërë.

### Do të kënaqeshit me barazimin nesër (sot)?

Nuk kënaqem me barazimin. Nesër si në çdo ndeshje do të futemi për të marrë tri pikët, pavarësisht se e di që do të jetë një ndeshje shumë e vështirë.

SUPERLIGA		
<b>Të premtën</b>		
Kamza-Skënderbeu	13:30	
Tirana - Flamurtari	16:30	
<b>Të shtunën</b>		
Teuta - Laçi	17:00	
<b>Të dielën</b>		
Kukësi - Kastrioti	13:30	
Luftëtari - Partizani	13:30	
<b>Renditja</b>		
Skuadra	N	P
Partizani17	3	6
Teuta	17	32
Kukësi	17	31
Skënderbeu	17	30
Laçi	17	29
Flamurtari	17	28
Luftëtari	17	16
Tirana	17	14
Kamza	17	12
Kastrioti	17	10

**Ideja e çmendur, Boka do Murinjon në stol**

Pak ditë pasi Zhoze Murinjo u shkarkua nga detyra si trajner i Manchester Juanjtidit, shumë skuadra kanë nisur të mendojnë për shërbimet e tij. Përveç Interit dhe Real Madridit, që tashmë dihet se kanë një interes ndaj portugezit, lajme të eja vijjnë edhe përtej oqeanit. Vetëm pak ditë më parë, Nikolas Burdiso u emërua di drejtor sportiv i Boka Zhuniorisit dhe për të treguar se e ka merituar këtë rol në klub, ai ka nisur që të punojë për të siguruar shërbimet e teknikut portugez. Humbja në Kupën Libertadores bëri që trajneri i skuadrës të paraqiste dorëheqjen pas humbjes ndaj River Plejtit dhe drejtuesit po mendojnë për një pasues të denjë. Nëse Murinjo pranonte të marrë drejtimin e Bokës, ai do të ndihmohej nga njëri prej heronjve të tripletës me Interin, duke qenë se Kambiaso mund të bëhet ndihmës i tij në Argentinë. Në ditët në vijim pritet që të ketë zhvillime të reja, megjithatë duket i vështirë si operacion për të ndodhur, pasi portugezi mund të synojë një klub të madh në Europë.

## VIZITA E SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM TË UEFA-S

Sekretari përgjithshëm i UEFA-s, Theodore Theodoridis, dhe Zoran Lakovic, drejtori i Federatave Kombëtare në UEFA kanë mbërritur sot në Tiranë dhe kanë ndjekur ecimin e punimeve në Shqipëri dhe në Arenën Ndërkombëtare. Theodoridis ka folur për mediat dhe tregon se është o befusuar me atë çka po ndodh në vendin tonë. "Qëllimi i vizitës sime është që të takoj një mikun tim të mirë para festave dhe të shikoj punimet në dy projektet e FSHF-së, stadiumin dhe zyrat e reja. Mund t'i un them që

## Theodoridis: I befusuar, por mos u fiksoni me Superkupën e Europës




kam mbetur i befusuar. Më vjen mirë që Shqipëria ka hyrë në epokën e modernizimit. Kemi edhe projektin

'Hat-Trick five' dhe jemi të gatshtëm t'u mbështesim me investime, sidomos kemi bërë edhe me federatën e tjera. Nuk jam këtu për të mbështetur kandidaturnë e presidentit Duka për Komitetin Ekzekutiv të UEFA-s, pavarësisht se ai është dhe ka qenë mik i im dhe përpara se të isha Sekretar i Përgjithshëm i UEFA-s", tha sekretari i përgjithshëm i UEFA-s. "Pse e kufizoni vet-

en vetëm në një kompeticion të vetëm?! Nuk e di nëse do të luhet Superkupa e Europës një ditë në Shqipëri. Fillimisht duhet të mbarojnë punimet dhe më pas FSHF të shpallë kandidaturnë. Por ka edhe kompeticionet të tilla përveç Superkupës. Ne jemi të gatshtëm dhe të hapur, por më pas vendos Komiteti Ekzekutiv", përfundoi Theodore Theodoridis.



**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

1. O Toole aktor
5. Si vizuale.
11. Në fund të lutjes.
13. Janë popullsi e qytetit
14. Një pije freskuese.
17. Eshhtë enjite.
18. Teke prize.
20. Janë mallkime shkishëruese.
22. Një aftësi paranormale.
25. Janë fjalitetet më me leverdi.
27. Gjëja e romakëve.
29. Thahan me bonifikim.
30. Zemeckis regjisor
33. Janë në temë
34. Inicialet e Harris aktor.
36. Eshhtë figurë gjeometrike.
37. Një markë makine qepëse.
41. Kush ka... ka zët.
42. Mbyllin komentin.

43. I bëhen të gjitha mikut.
45. Një version i dikurshëm i FIAT.
46. Fillojnë shkurt.
47. Një pikë në ligji.
48. Inicialet e Morricone-s.
49. Të fundit në manastir.
50. I ka kërcyer të xhindosurit.
51. Janë pjesë të dramës

**VERTIKAL**

1. Fillojnë panikun.
2. Ai i trëndafilut është i Umberto Eco-s.
3. Në krye të tenorëve.
4. Mund të jetë gjaku dhe kuzhine.
5. Inicialet e Anka këngëtar.
6. Kush ka... ka nevojë për gjak
7. Ndiqet ajo e fundit
8. Duken të gjata në pritje.
9. Një fazë gjumi.
10. Shteti i francezëve
12. Një art i shtatë.
13. Eshhtë pellgu.
15. Shkroi Pa familje
16. Janë dokumente shtëpie.
18. Eshhtë filmi që mallëngjien.
19. Një koleg anglez.
21. Janë baballarët.
23. Mund të jetë elektrike.
24. Eshhtë hidrofobi.
26. Ajo e forcës është për të çmendur.
27. Kremi pa ekstreme.
28. Si sezonale.
31. Mund të jenë unike
32. Mund të jenë periode të tilla.
35. Eshhtë bishë që zgërdhinet.
38. Fillojnë nazet
39. Inicialet e Diamanti aktor.
40. Eshhtë moshë më e bukur.
44. Fillojnë temën.
46. Kufizojnë një send.

**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**


1. Një film publicitar
5. Në krye të bashkisë
7. Me Romeo në makinë
10. Në fund majtas
11. Janë kompozime si Vejusha gazmore
15. Janë në masë.
16. Janë melodrama.
17. Fillojnë dobët.
18. Në hyrje të radios.
19. Një pjesë e lipotimisë.
21. Eshhtë gjendje të fikti.
24. Eshhtë vërtet i mërztitshëm.
25. Maiden që këndojnë
26. Hurlley aktore.
27. Pak torturuese.
28. Ekstreme në tunel.
29. Ndezur në aparaturë.
30. Ai i shenjtë është papa.
31. Merrte fuqi nga toka.

**VERTIKAL**

32. Pak enigmatike.
33. Ngriset në mbremje.
35. Kufij itinerari.
36. Ai i harrës është Leti.
39. Eshhtë porosia e fundit.
41. Janë bimë uji.
42. Opera e Mascagni-t.
44. Magritte piktor.
46. Eshhtë ndenjësë zburkuri.
48. Ndiqen më ilaça.
50. Në krye të armiqve.
51. Një godinë në miniaturë
52. Eshhtë muzika... më e kollajtë.


**VERTIKAL**

1. Qe mbreti i parë i Izraelit.
2. Post scriptum
3. Një sferë... për model.
4. Eshhtë infeksion në bark




5. Një mund të jetë arme.
6. Në krye të atletëve.
7. Eshhtë grimcë me bërthamë.
8. Ishte sundimtar si Tutankamon
9. Masat pa kufij
12. Një sport baskësh
13. Janë marrëdhënie.
14. Padia pa kufij.
16. Eshhtë në minorancë.
20. I ka shumë të goditura Agron Llakaj.
22. Kështu janë lojtarë te formaconit
23. Janë të holla dhe therëse.
26. Makinë ruse.
32. Eshhtë dita e dytë
34. Bisha aktore.
37. Në mes të rrugës.
38. Një trup pa kënde.
40. Satie kompozitor.
43. I ka të ndryshme një sakat.
45. King Cole i muzikës.
46. Inicialet e Penn aktor.
47. Në mes të dhomës.
49. Të fundit në spital.

**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOKU**

		2	9			8		3
9	5	4					1	
			2	1				7
	9			6	3		7	8
5			4		8			1
4	3		7	9				2
7				3	9			
	1					7	6	5
8		6			5	2		

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

4	2	8	9	3	7	1	5	6
6	5	1	4	8	2	9	7	3
7	9	3	1	5	6	8	2	4
8	1	6	2	4	3	5	9	7
3	4	2	5	7	9	6	1	8
5	7	9	6	1	8	3	4	2
9	3	4	7	6	1	2	8	5
1	8	7	3	2	5	4	6	9
2	6	5	8	9	4	7	3	1

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

*Argëtim filozofik*

"Momenti magjik është momenti kur një "po" ose "jo" mund të ndryshojë tërë ekzistencën tonë".

"Më duhet ta humbja për të kuptuar se shijen e gjërave që gjejmë përsëri është mjalti më i ëmbël".

Nëse e doni veten atëherë i doni të tjerët, nëse e urreni veten, atëherë urreni të tjerët sepse marrëdhëniet tuaja me të tjerët janë thjesht përfaqësimi i vetes.

- Shiu bie kur retë nuk mund të mbajnë më peshën...  
Lotët bien kur zemra nuk mund të mbajnë më dhimbjen.

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**

Përgjigja e numrit të djeshëm

15	D	1	7	2	5	1	4	2	17	6	2	4	A	P	A	P	E	K	E	N	D	E	T
6	O	2	3	10	11	13	17	4	9	3	2	1	D	I	A	B	E	T	I	D	E	T	I
12	B	7	8	6	9	6	13	4	6	17	7	7	R	A	K	L	K	A	P	E	L	E	T
7	I	11	7	2	6	1	4	2	2	4	8	8	F	E	N	I	M	O	R	E	T	R	
18	3	1	4	12	4	1	4	2	1	1	3	2	R	A	T	A	K	E	M	E	T	P	E
2	3	12	2	3	12	3	16	1	3	3	3	3	A	N	T	E	N	A	T	A	A	B	
16	3			4	15		16	2	7				N	A	N	T	E	S	T	L	A	R	A
15		2	4	8	16	2	12	7	2	4	2	2	K	N	E	I	I	L	I	R	E	T	
4	18		1	1	7		8	7	9	6	13	7	I	B	A	N	A	K	A	E	T		
12	7	1	7	3	12		8	1	4	1	4	2	B	A	R	I	A	L	E	T	N	E	D
7	2	3		10	7	3		3	2	7	6	6	E	B	A	S	T	I	A	F	A	T	I

- Mërzitja është një humbje kohe... asgjë nuk ndryshon, më përjashtim ngatërrimit e mendimeve dhe vjedhjen e lumturisë tuaj!!!
- Nuk jemi qenie njerëzore që kanë përvojë shpirtërore. Jemi qenie shpirtërore që kanë përvojë njerëzore.

- Në përpjekje ... për të bërë të tjerët të lumtur ... kam harruar veten time !!!
- Pengesa më e madhe është frika ... ndjenja më e keqe është zemërimi... dhe gabimi më i madh është braktisja !!!

*Thënie të mençura*

PËRGJIGJET E FJALËKRYQIJE TË NUMRIT TË KALUAR

DAVID ROCK LKR  
EMERKEA SEAN  
MALLOT KENETAT  
IN NIM RGMANET  
R RPASIVET  
MOKASINA IDEM  
EMIRATI AVATI  
STANE ATOMIK N  
AR STRETE OD  
RASE M I KORE  
ATAKATIT DAR  
H STARR STRARI

BALENA AM MOTI  
ENKAGALUMA  
KIMIKR KARRITE  
ITPALETTIRITIA  
MATPETALETTMR  
TI MAKETTETKOT  
KALKULIMETTRE  
MULERMETALLE  
ANBETARTPOTIE  
NATIEPTETIDIE  
ETIEMINATORET  
TITRENTAFANTI

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)



